FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 30

Tiranë – E mërkurë, 4 mars 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 8980, datë 24.2.2015	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	1349
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 158, datë 25.2.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 835, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes", të ndryshuar.....	1349
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 159, datë 25.2.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 944, datë 9.10.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit".....	1350
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 162, datë 25.2.2015	Për një shtesë në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	1351
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 163, datë 25.2.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i objektit "Studim, projektim, lidhja e rrugës transballkanike me superstradën Fier-Vlorë"".....	1351
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 164, datë 25.2.2015	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 1.4.2014, për çështjen "Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë" (për ankimet nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09").....	1354
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 165, datë 25.2.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 180, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për pagesën e vlerës së mbetur të detyrimit për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07, nr. 34770/09, "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë"".....	1355

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 166, datë 25.2.2015	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.3.2014, për çështjen "Memishaj kundër Shqipërisë" (për ankimin nr. 40430/08).....	1355
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 25.2.2015	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.6.2014, për çështjen "Eltari kundër Shqipërisë" (për ankimin nr. 16530/06).....	1356
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 168, datë 25.2.2015	Për disa ndryshime në vendimin nr. 172, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.1.2013, për çështjen nr. 49106/06, "Delvina kundër Shqipërisë"", të ndryshuar.....	1357
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 169, datë 25.2.2015	Për planin vjetor të pranimit në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2015.....	1357
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 25.2.2015	Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike.....	1359
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 172, datë 25.2.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv Korçë – Zëmblak.....	1379
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 173, datë 25.2.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv Ersekë-Korçë.....	1383
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 175, datë 25.2.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Porto Romano-Durrës, loti I".....	1390
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 176, datë 25.2.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 28, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime", të ndryshuar.....	1391
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 177, datë 25.2.2015	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin "RSM", në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut, në Afganistan.....	1391
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 25.2.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 145, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues në shtabin "EUFOR", në kuadër të operacionit ushtarak "Althea", të Bashkimit Evropian, në Bosnjë-Hercegovinë", të ndryshuar.....	1392
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 182, datë 25.2.2015	Për përcaktimin e procedurës për përzgjedhjen e rregulluesit kryesor (*lead manager*) dhe/ose huadhënësit për realizimin e huamarrjes me instrumente financiare në tregun e huaj.....	1393

DEKRET
Nr. 8980, datë 24.2.2015

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Gylberta Mehmet Xhelili (Muda)
2. Alvi Atli Xhelili
3. Heldi Atli Xhelili
4. Dea Atli Xhelili
5. Daniel Atli Xhelili
6. Aleksandar Nikoll Kontić
7. Ivana Aleksandar Kontić
8. Shaqe Marash Smajlaj
9. Nedelko Spaso Rajçeviç
10. Zoranka Spaso Rajçeviç
11. Kadri Sulejman Kani
12. Klaudia Thanas Lena
13. Zoran Danil Popović (Popaj)
14. Mirjana Arso Popović (Jakoja)
15. Rajdona Bajram Zeqiri
16. Pamela Bashkim Shehu
17. Besnik Qazim Spahiu
18. Ilirjan Qazim Katana
19. Klodian Vasil Ferro
20. Valbona Emin Isufi
21. Ervina Halil Bushi
22. Rasim Agron Kallfa
23. Mimoza Sami Leka
24. Valentina Gjon Shehaj (Niklekaj)
25. Dea Alejdin Shehaj
26. Enid Alejdin Shehaj
27. Onerda Bashkim Randazzo (Malo)
28. Marin Kristo Fara
29. Azeta Mensur Nissen (Demiri)
30. Elona Agim Nostroff (Elezi)
31. Elvina Petrit Veliu (Jovani)
32. Etleva Kosta Brandth (Kuçuqi)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 158, datë 25.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 835, DATË 18.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 835, datë 18.9.2013, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titullin e vendimit dhe kudo në vendim emërtimi "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" zëvendësohet me "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes".

2. Kreu II ndryshohet, si më poshtë vijon:

"II. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes përgatit dhe zbaton politikat e qeverisë në sferën ekonomike, të turizmit, të tregtisë dhe të sipërmarrjes për ndërtimin e një modeli të ri ekonomik, me synim rritjen ekonomike, të lartë e të qëndrueshme në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politika të integruara ekonomike në sektorët parësorë të ekonomisë, turizmit, konvergjimit ekonomiko-social të rajoneve të vendit, përmirësimit të klimës dhe shërbimeve për biznesin dhe sipërmarrjen.".

3. Pas pikës 34, të kreut III, shtohen pikat 35, 36, 37, 38, 39 dhe 40, si më poshtë vijon:

"35. Të hartojë dhe të zbatojë politika për një

zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, ngritjes dhe monitorimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit në vazhdim të biznesit në fushën e turizmit, promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit dhe bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor, dhe funksione të tjera, të cilat do të mbulohen nga institucionet e varësisë, aparati i ministrisë dhe degët territoriale.

36. Të kontrollojë ndryshimet e regjimit tregtar mbi eksport-importet.

37. Të ndjekë në vazhdimësi procesin e krijimit dhe monitorimit të zonave ekonomike.

38. Të sigurojë në kohë dhe në mënyrë profesionale informacionet e nevojshme dhe të kërkuara lidhur me zbatimin e politikave dhe objektivave të sektorit; të kontribuojë dhe monitorojë në bashkëpunimin edhe me institucionet e tjera për realizimin e kushteve të domosdoshme infrastrukturore për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike.

39. Mbulimi i çështjeve të standardizimit të shpronësimeve është emergjencë dhe domosdoshmëri, për shkak të përfshirjes edhe të zonave ekonomike dhe detyrimit për zbatimin e legjislacionit për këto zona, si dhe të unifikimit të trajtimit të praktikave dhe zgjidhjes së problemeve që dalin gjatë implementimit të projekteve në zbatim.

40. Verifikimi i efiçencës së përdorimit të burimeve ekonomike, që nga trajtimi i tyre nga autoritetet kontraktuese deri në pagesën e detyrimeve që dalin nga procesi i shpronësimit.”.

4. Pas pikës 8, të kreut V, shtohen pikat 9 dhe 10, si më poshtë vijon:

“9. Agjencinë Kombëtare të Turizmit (AKT);

10. Inspektoratin e Mbikëqyrjes në fushën e turizmit.”.

5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 159, datë 25.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 944, DATË 9.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 944, datë 9.10.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit” zëvendësohet me “Ministria e Zhvillimit Urban”.

2. Në fund të kreut II, fjalët “… dhe turizmit.” hiqen.

3. Kreu III ndryshohet, si më poshtë vijon:

“III. Ministria e Zhvillimit Urban ushtron, në përputhje me legjislacionin përkatës, veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

1. Fushën e planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, administrimit të tokës dhe kontrollit të zhvillimit të territorit;

2. Fushën e legalizimit, urbanizimit dhe integrimit të zonave e ndërtimeve informale;

3. Fushën e standardeve urbane në ndërtim;

4. Fushën e strehimit;

5. Fushën e mbetjeve urbane në lidhje me planifikimin territorial;

6. Fushën e menaxhimit të projekteve të zhvillimit urban.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 162, datë 25.2.2015

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1 dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar, të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën AL-Qaida", regjistrohen individët e renditur në shkronjën "a" të listës, "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën AL-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesës në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën AL-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT ("LISTA E OKB-së")

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida";

1. DENIS; MAMADOU; GERHARD; CUSPERT

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM
Nr. 163, datë 25.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 54, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I OBJEKTIT "STUDIM, PROJEKTIM, LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER-VLORË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera 516 898 914.92 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë ndryshon dhe bëhet 582 942 635.82 (pesëqind e tetëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e dy) lekë.

2. Tabela bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Nr	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit, lekë	Çmimi i ndërtimit, lekë	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera truall dhe ndërtesë	Shënime
1	8605	33/426	Skender Alibehaj	64.1	0	8300	52,024.00	532,030.00	-	532,030.00	Konfirmuar nga ZVRPP
2	8605	33/377	Metlli Sinanaj	68.2	98.6	8300	52,024.00	566,060.00	5,129,566.40	5,695,626.40	Konfirmuar nga ZVRPP
3	8605	33/373	Metlli Sinanaj	168.7	76	8300	52,024.00	1,400,210.00	3,953,824.00	5,354,034.00	Konfirmuar nga ZVRPP
4	8605	33/402	Sami Kembaci	185	42.2	8300	52,024.00	1,535,500.00	2,195,412.80	3,730,912.80	Konfirmuar nga ZVRPP
5	8605	33/375	B.P. Mersini	146	82.5	8300	52,024.00	1,211,800.00	4,291,980.00	5,503,780.00	Konfirmuar nga ZVRPP
6	8605	33/19	B.P. Mucaj	0	60	8300	52,024.00	-	3,121,440.00	3,121,440.00	Konfirmuar nga ZVRPP
7	8605	33/345-Nd	Flamur Hoxha	0	63.7	8300	52,024.00	-	3,313,928.80	3,313,928.80	Konfirmuar nga ZVRPP
8	8605	33/45-ND	Matilda Bufazi	0	71	8300	52,024.00	-	3,693,704.00	3,693,704.00	Konfirmuar nga ZVRPP
9	8605	33/371	Matilda Bufazi	23.2	0	8300		192,560.00	-	192,560.00	Konfirmuar nga ZVRPP
10	8605	33/399	Danish Hoxhaj	272	99	8300	52,024.00	2,257,600.00	5,150,376.00	7,407,976.00	Konfirmuar nga ZVRPP sipërfaqe banimi
11	8605	33/399	Danish Hoxhaj	0	72		52,024.00		911,875.00	911875	Konfirmuar nga ZVRPP Siperfaqe zdrukthtarie vleresim me situacion
12	8605	33/410 (33/310)	B.P. Bataj	239	111	8300	52,024.00	1,983,700.00	5,774,664.00	7758364	Konfirmuar nga ZVRPP
13	8605	33/381	Edmond Bregu	84.5	109	8300	52,024.00	701,350.00	5,670,616.00	6371966	Hipotekohet në emer te Bankes PRO Credit Konfirmuar nga ZRPP
14	8605	33/382	Dashamir Rrapushi	367.1	131.4	8300	52,024.00	3,046,930.00	6,835,953.60	9882883.6	Konfirmuar nga ZVRPP
15	8605	33/358	Zace Sejdi	184.1	115.9	8300	52,024.00	1,528,030.00	6,029,581.60	7,557,611.60	Konfirmuar nga ZVRPP
16	8605	33/364	Lutfi Shuaipi	214.2	85.8	8300	52,024.00	1,777,860.00	4,463,659.20	6,241,519.20	Konfirmuar nga ZVRPP
17	8605	33/365	Thabit Shuaipi	161	139	8300	52,024.00	1,336,300.00	7,231,336.00	8,567,636.00	Konfirmuar nga ZVRPP
18	8605	33/372	Xhelal Mezani	234	66	8300	52,024.00	1,942,200.00	3,433,584.00	5375784	Konfirmuar nga ZVRPP
19	8605	33/379	Enver Mezani	305.5	374	8300	52,024.00	2,535,650.00	18,112,376.00	20648026	Konfirmuar nga Zvrpp 2 kate, 162 m2 secili. Mbajtur vlera e truallit per katin e dyte
20	8605	33/390	Pellumb Lule	189.1	65.2	8300	52,024.00	1,569,530.00	3,391,964.80	4961494.8	Konfirmuar nga ZVRPP
21	8605	33/400	Et'hem Driza	134.6	369.7	8300	52,024.00	1,117,180.00	17,537,582.80	18654762.8	Konfirmuar nga ZVRPP kati I 165.4 m2, kati II 204.3 m2. Mbajtur vlera e truallit per katin II
22	8605	33/418	Metlli Shehu	248.2	80.8	8300	52,024.00	2,060,060.00	4,203,539.20	6,263,599.20	Konfirmuar nga ZVRPP
23	8605	2/201	Alban Gjolekaj	296.8	223	8300	52,024.00	2,463,440.00	10,572,152.00	13035592	Ne favor te Intesa San Paolo. Konfirmuar nga ZRPP 2 kate, K I 99 m2, K II 124 m2. Mbajtur vlera e truallit per katin e dyte
24	8605	2/57+1-3	Bp. Diku		50		52,024.00		2,601,200.00	2601200	Konfirmuar nga ZRPP
25	8605	2/57+1-1	Bp. Hysaj		50		52,024.00		2,601,200.00	2601200	Konfirmuar nga ZRPP
26	8605	2/57+1-2	Bp. Hameti		65		52,024.00		3,381,560.00	3381560	Konfirmuar nga ZRPP
27	8605	33/368	Miroshe Metushaj	27.5	0	8300	52,024.00	228,250.00	-	228250	Konfirmuar nga ZVRPP
28	8605	33/331	B.P. Agalliu	600	0	8300	52,024.00	4,980,000.00	-	4980000	Konfirmuar nga ZVRPP
29	8605	33/335	B.P Agalliu	1166	0	8300	52,024.00	9,677,800.00	-	9677800	Konfirmuar nga ZVRPP
30	8605	33/340	B.P. Alibehaj	23.1	0	8300	52,024.00	191,730.00	-	191730	Konfirmuar nga ZVRPP
31	8605	33/323	B.P. Agalliu	82.2	0	8300	52,024.00	682,260.00	-	682260	Konfirmuar nga ZVRPP
32	8605	33/408	Hiqmet Shoraj	96.3	0	8300	52,024.00	799,290.00	-	799290	Konfirmuar nga ZVRPP
33	8605	22/273	Mustafa Myzeqari	20.7	0	8300	52,024.00	171,810.00	-	171810	Konfirmuar nga ZVRPP
34	8605	33/333	B.P. Agalliu	445.16	0	8300	52,024.00	3,694,828.00	-	3694828	Konfirmuar nga ZVRPP
35	8605	11/73	Moisi Lazaj	194	0	8300	52,024.00	1,610,200.00	-	1610200	Konfirmuar nga ZVRPP
36	8605	11/75	B.P. Lulja	1848.5	0	8300	52,024.00	15,342,550.00	-	15342550	Konfirmuar nga ZVRPP
37	8605	11/84	Riza Lule	1511.9	0	8300	52,024.00	12,548,770.00	-	12548770	Konfirmuar nga ZVRPP
38	8605	11/92	B.P. Agalliu	2045.4	0	8300	52,024.00	16,976,820.00	-	16976820	Konfirmuar nga ZVRPP
39	8605	11/140	Shoqeria "Selmani" SH.P.K	506.6	0	8300	52,024.00	4,204,780.00	-	4204780	Konfirmuar nga ZVRPP
40	8605	11/141	B.P. Agalliu	8385.9	0	8300	52,024.00	69,602,970.00	-	69602970	Konfirmuar nga ZVRPP

41	8605	2/35	B.P. Agalliu	3687	0	8300	52,024.00	30,602,100.00	-	30602100	Konfirmuar nga ZVRPP
42	8605	2/65	B.P. Agalliu	2710.6	0	8300	52,024.00	22,497,980.00	-	22497980	Konfirmuar nga ZVRPP
43	8605	11/118	Mirjam Ibrahimi	3594	0	8300	52,024.00	29,830,200.00	-	29830200	Konfirmuar nga ZVRPP
44	8605	11/139	B.P. Agalliu	1040	0	8300	52,024.00	8,632,000.00	-	8632000	Konfirmuar nga ZVRPP
45	8605	2/208	B.P. Agalliu	5125.1	0	8300	52,024.00	42,538,330.00	-	42538330	Konfirmuar nga ZVRPP
46	8605	2/209	B.P. Agalliu	731	0	8300	52,024.00	6,067,300.00	-	6067300	Konfirmuar Nga ZVRPP
47	8605	11/82	Ibrahim Bino	4877.2	0	8300	52,024.00	40,480,760.00	-	40480760	Konfirmuar nga ZVRPP
48	8605	33/417	Maksim Hitaj	382	81	8300	52024	3170600	4213944	7384544	Konfirmuar nga ZVRPP banese
49	8605	33/417	Maksim Hitaj		41				693825	693825	Konfirmuar nga ZVRPP, objekt soc-ek, vlera sipas situacionit
50	8605	2/35-nd	Eduart Feka		116	8300	52,024.00	962,800.00	6,034,784.00	5,071,984.00	Saktësim dokumentacioni
51	8605	33/344-Nd	Kudret Zhorri	0	63.7	8300	52,024.00	-	3,313,928.80	3313928.8	Saktësim dokumentacioni
52	8605	33/343-Nd	Bp. Mehmeti	23.32	82.68	8300	52,024.00	193,556.00	4,301,344.32	4494900.32	Saktësim dokumentacioni
53	8605	33/359	Gjyzela Alibehaj	54		8300		448,200.00		448,200.00	Saktësim dokumentacioni
54	8605	33/360	Gjyzela Alibehaj	54		8300		448,200.00		448,200.00	Saktësim dokumentacioni
55	8605	33/404	Agim Shehu	225.3	64.7	8300	52024	1869990	3365952.8	5235942.8	Saktësim dokumentacioni
56	8605	33/431-ND 3	Izet Shuaipi	0	36.57	8300	52030	303531	1902737.1	1599206.1	Konfirmuar nga ZRPP
57	8605	2/208-ND	Haki Haxhiraj	0	52.17	8300	52030	433011	2714405.1	2281394.1	Konfirmuar nga ZRPP
58	8605	33/431-ND1	Petrit Ismail Shuaipi	0	63.94	8300	52030	530702	3326798.2	2796096.2	Konfirmuar nga ZRPP
59	8605	2/65-ND1	Bashkim Kasa	0	83.12	8300	52030	689896	4324733.6	3634837.6	Konfirmuar nga ZRPP
60	8605	33/431-ND4	Adile Shuaipi	0	65.03	8300	52030	539749	3383510.9	2843761.9	Konfirmuar nga ZRPP
61	8605	33/431-ND2	Xhafer Ismail Shuaipi	0	56.41	8300	52030	468203	2935012.3	2466809.3	Konfirmuar nga ZRPP
62	8605	33/391-ND2	Arben Lule	0	70.15	8300	52030	582245	3649904.5	3067659.5	Konfirmuar nga ZRPP
63	8605	33/391-ND1	Gezim Haxhi Lule	0	63.13	8300	52030	523979	3284653.9	2760674.9	Konfirmuar nga ZRPP
64	8605	2/65-ND3	Bilbil Llojaj	0	62.24	8300	52030	516592	3238347.2	2721755.2	Konfirmuar nga ZRPP
65	8605	2/65-ND2	Armando Salataj	0	50.84	8300	52030	421972	2645205.2	2223233.2	Konfirmuar nga ZRPP
66	8605	33/54-ND	Zenel Qamil Qamili	0	77.55	8300	52030	643665	4034926.5	3391261.5	Konfirmuar nga ZRPP
67	8605	33/222ND	Emin Shehu	0	64.24	8300	52030	533192	3342407.2	2809215.2	Konfirmuar nga ZRPP
68	8605	33/430	Kastriot Lelaj	398.2	97	8300	52030	3305060	5046910	8351970	Konfirmuar nga ZRPP
69	8605	33/335/3	Nure Omeri	143.1	347.1	8300	52030	1187730	18059613	19247343	Konfirmuar nga ZRPP, 2 kate, kati I 156.9 m2, kati II 190.2 m2. Mbajtur vlera e truallit per kII
70	8605	2/208/2	Lavdosh Xhaferaj	223.9	48.3	8300	52030	1858370	2513049	4371419	Konfirmuar nga ZRPP
71	8605	33/344	Kudret Kapaj	116.1	16	8300	52030	963,630.00	832,480.00	1,796,110.00	Konfirmuar nga ZRPP
72	8605	33/28ND	Bajram Mustafa Guaci	-	109	8300	52030	904,700.00	5,671,270.00	4,766,570.00	Saktësim dokumentacioni
										582,942,635.82	

VENDIM
Nr. 164, datë 25.2.2015

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 1.4.2014, PËR ÇËSHTJEN "LULI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMET NR. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 DHE 31355/09")

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 1.4.2014, për çështjen "Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë", (për ankimet nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09"), me shumat:

- 1 500 (një mijë e pesëqind) euro, plus taksat që mund të vihen në ngarkim, lidhur me dëmin jopasuror, në favor të të gjithë ankuesve, në lidhje me ankimin nr. 64480/09;

- 1 500 (një mijë e pesëqind) euro, plus taksat që mund të vihen në ngarkim, lidhur me dëmin jopasuror, në favor të të gjithë ankuesve, në lidhje me ankimin nr. 64482/09;

- 1 500 (një mijë e pesëqind) euro për kostot dhe shpenzimet në lidhje me ankimet nr. 64480/09 dhe nr. 64482/09; dhe

- 500 (pesëqind) euro për kostot dhe shpenzimet në lidhje me ankimin nr. 56935/10.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku janë depozituar, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, në shumat që ka detyrim shteti shqiptar për secilin prej tyre, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 1.4.2014, për çështjen "Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë".

4. Pagesa e shumave të depozituara, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor, për kryerjen e pagesave, nga buxheti i shtetit, brenda një afati 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme të paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Nr.	Nr. i ankimit dhe data e paraqitjes	Emri i ankuesit dhe datëlindja (nëse dihet)	Përfaqësuar nga (si të jetë i zbatueshëm)
1.	31355/09 15.06.2009	Afërdita Luli, 18.11.1949	Elira Kokona Erinda Meli, avokate
2.	64480/09 15.06.2009	Yllka Zhupa, 3.6.1947	
3.	64482/09 15.06.2009	Leticja Mujo, 15.8.1968 Ruben Celkupa, 14.4.1935 Dora Celkupa, 28.7.1936 Xhani Celkupa, 23.3.1942 Belino Voshtina (i cili zëvendësoi Saimir Voshtinën)	
4.	12874/10 15.02.2010	Rita Pistulli, 23.5.1938	Asnjë
5.	56935/10 18.09.2010	Eda Dushallari, 1921	Violeta Dushallari (e afërmja e ankueses)
6.	3129/12 07.01.2012	Hodo Kekenezi, 4.9.1939	Asnjë

VENDIM
Nr. 165, datë 25.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 180, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGESËN E VLERËS SË MBETUR TË DETYRIMIT PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 31.7.2012, PËR ANKIMET NR. 604/07, NR. 43628/07, NR. 46684/07, NR. 34770/09, "MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 1, 4 dhe 5, të vendimit nr. 180, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për pagesën e pjesës së mbetur të detyrimit.

Për ankimin nr. 34770/09 në favor të znj. Shqipe Muka bëhet pagesa 680 000 (gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) euro në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.".

"4. Pagimi i shumës për pjesën e mbetur të detyrimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, në favor të ankuesve, bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

Për vonesën në ekzekutimin e vendimit, bazuar në pagesat pjesore të kryera, do të paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind. Interesat do të llogariten nga data 18.3.2013 deri në datën e kryerjes së pagesës së plotë të principalit të detyrimit.

5. Efekti financiar për pagimin e interesave të përballohet nga fondi kontingjencës.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 166, datë 25.2.2015

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 25.3.2014, PËR ÇËSHTJEN "MEMISHAJ KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMIN NR. 40430/08)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.3.2014, për çështjen "Memishaj kundër Shqipërisë" (për ankimin nr. 40430/08), në shumën 4 700 (katër mijë e shtatëqind) euro, në lidhje me dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme, si dhe shumën prej 3 000 (tre mijë) eurosh, në lidhje me kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera, e përcaktuar si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlera, e përcaktuar si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z. Enver Memishaj, në shumën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 25.3.2014, për çështjen "Memishaj kundër Shqipërisë".

4. Pagesa e shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesit, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor, për kryerjen e pagesave, nga buxheti i shtetit, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme të paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 167, datë 25.2.2015

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.6.2014, PËR ÇËSHTJEN "ELTARI KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR ANKIMIN NR. 16530/06)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.6.2014, për çështjen "Eltari kundër Shqipërisë" (për ankimin nr. 16530/06), në shumën 44 000 (dyzet e katër mijë) euro, në lidhje me dëmin pasuror, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme, si dhe shumën prej 3 000 (tre mijë) eurosh, në lidhje me kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlera e përcaktuar si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankueses, znj. Zamira Eltari (Sharra), në shumën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.6.2014, për çështjen "Eltari kundër Shqipërisë".

4. Pagesa e shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të ankueses, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave, nga buxheti i shtetit, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme të paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 168, datë 25.2.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 172, DATË 26.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 15.1.2013, PËR ÇËSHTJEN NR. 49106/06, "DELVINA KUNDËR SHQIPËRISË"", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pikat 4 dhe 5, të vendimit nr. 172, datë 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 15.1.2013, për çështjen nr. 49109/06, "Delvina kundër Shqipërisë" të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

"4. Pagesa e shumës për pjesën e mbetur të detyrimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, në favor të ankuesve, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

Për vonesën në ekzekutimin e vendimit, bazuar në pagesat pjesore të kryera, do të paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind. Interesat do të llogariten nga data 8.1.2014 deri në datën e kryerjes së pagesës së plotë të principalit të detyrimit.

5. Efekti financiar për pagimin e interesave të përballohet nga fondi i kontingjencës.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 169, datë 25.2.2015

PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2015

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i vendeve vakante, të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2015, është, gjithsej, 760, ndarë sipas kategorive të mëposhtme:

a) Për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND) 30;
b) Për kategorinë e mesme drejtuese 40;
c) Për kategorinë e ulët drejtuese 180;
ç) Për kategorinë ekzekutive 510.

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, në kategorinë ekzekutive, janë si më poshtë:

- Shkenca Juridike;
- Shkenca Kompjuterike;
- Audit i Brendshëm;
- Shkenca Ekonomike;
- Shkenca Shoqërore;
- Shkenca Sociale;
- Histori-Filologji;
- Teologji;
- Shkenca Mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Inxhinieri;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Artet e Bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca Ekzakte;
- Shkenca Edukimi;
- Mësuesi;
- Arsim i Lartë Ushtarak/policor.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2015, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Lista e institucioneve të administratës shtetërore ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2015

1. Kryeministria
2. Agjencia Telegrafike Shqiptare
3. Komisioni i Prokurimit Publik
4. Akademia e Shkencave
5. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
6. Instituti i Statistikave në nivel qendror dhe rajonal
7. Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
8. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
9. Departamenti i Administratës Publike
10. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar
11. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në nivel qendror dhe rajonal
12. Inspektorati Shtetëror i Pyjeve, Mjedisit dhe Ujërave në nivel qendror dhe rajonal
13. Aparati i Ministrisë së Mbrojtjes
14. Aparati i Ministrisë së Kulturës
15. Aparati i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
16. Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel qendror dhe rajonal
17. Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror dhe rajonal
18. Aparati i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë
19. Reparti i Inspektim Shpëtim Minierave
20. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
21. Aparati i Ministrisë së Integrimit Evropian
22. Aparati i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës
23. Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
24. Autoriteti i Aviacionit Civil
25. Organi Kombëtar i Investigimt të Incidenteve/Aksidenteve Ajrore
26. Autoriteti Rrugor Shqiptar në nivel qendror dhe rajonal
27. Drejtoria e Përgjithshme Detare në nivel rajonal
28. Aparati i Ministrisë së Punëve të Jashtme
29. Aparati i Ministrisë së Shëndetësisë
30. Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
31. Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore
32. Aparati i Ministrisë së Drejtësisë
33. Komiteti Shqiptar i Birësimeve
34. Instituti i Mjekësisë Ligjore
35. Aparati i Ministrisë së Zhvillimit Urban
36. Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit
37. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
38. Agjencia Kombëtare e Turizmit
39. Zyra e Shërbimit Turistik në nivel qendror dhe rajonal
40. Agjencia Kombëtare e Bregdetit në nivel qendror dhe rajonal
41. Aparati i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
42. Qendra Kombëtare e Licencimit
43. Agjencia e Trajtimit të Koncensioneve
44. Agjencia Shtetërore e Zhvillimit të Investimeve
45. Qendra Kombëtare e Regjistrimit
46. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë në nivel qendror dhe rajonal
47. Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave
48. Aparati i Ministrisë së Financave
49. Degë Thesari në nivel vendor
50. Agjencia e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
51. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
52. Tatimpaguesit e Mëdhenj Tiranë
53. Drejtoritë rajonale tatimore
54. Qendra e Trajnimit të Administratës Tatimore-Doganore
55. Aparati i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit
56. Zyrat arsimore rajonale
57. Drejtoritë arsimore rajonale

58. Aparati i Ministrisë së Punëve të Brendshme
59. Policia e Shtetit
60. Prefekturat
61. Nënprefekturat
62. Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave
63. Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve
64. Drejtoritë e Bujqësisë në nivel vendor
65. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në nivel qendror dhe rajonal

VENDIM
Nr. 171, datë 25.2.2015

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË RIMËKËMBJES FINANCIARE TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "E", të Seksionit IV, dhe pikës 22, të shtojcës, që i bashkëlidhen marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, të ratifikuar me ligjin nr. 170/2014, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

PLANI I RIMËKËMBJES FINANCIARE TË SEKTORIT TË ENERGJISË

I. PËRMBLEDHJE

Qëllimi i këtij Plani të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë është i dyanshëm: i) të ofrojë një pamje të plotë dhe të detajuar të situatës financiare të sektorit të energjisë elektrike, shkaqet kryesore dhe mësimet e nxjerra deri tani; dhe ii) të propozojë një plan të rimëkëmbjes financiare shoqëruar me një plan veprimi për 5 vitet e ardhshme.

Vlerësimi arrin në përfundimin se efekti i përgjithshëm financiar i veprimeve të ndërmarra nga Qeveria deri më sot (sikurse paraqiten në aneksin I dhe në mënyrë të përmbledhur në fig. I më poshtë) tregon se kombinimi i masave të vazhdueshme dhe atyre që ndërmerren vetëm një herë është i kontrollueshëm në këtë periudhë kyçe nga sot deri në vitin 2017, pas së cilës sektori do të arrijë një fluks të parasë (*cash*) pozitiv dhe do të hyjë në një proces që do të çojë në një pozitë të shëndoshë financiare nëpërmjet:

Masave që kryhen në mënyrë të vazhdueshme, të tilla si: përmirësimi i arkëtimeve për faturimet, përpjekje për reduktimin e humbjeve, ristrukturimi i tarifave, racionalizimi i operacioneve të biznesit, veçanërisht në OSHEE, lëshimi i Garancive Qeveritare për Shpenzimet Kapitale (*Capex*) (në rend zbritës), ristrukturimi i kërkesave për kreditë tregtare afatshkurtra (overdraft) dhe forcimi i zbatimit të disiplinës së pagesave mes kompanive të sektorit[1] dhe nga institucionet shtetërore; dhe

Masave që merren për herë të parë, të tilla si shuarje me kompensim të detyrimeve të institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore (*netting-off*), reforma në strukturën e modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, pastrimi i detyrimeve të prapambetura ndaj PPE/Ashta dhe injektime të mundshme në kapitalin e vet (*equity*) të OSHEE.

Ka rreziqe që duhet të menaxhohen, veçanërisht në tri aspekte: raporti i borxhit total me vlerën totale të aseteve (leva financiare), varësia nga ndryshueshmëria e motit dhe plani i zbatimit.

Duke marrë parasysh procesin premtues të rimëkëmbjes, të ndërmarrë me mbështetje të fortë politike, sistemi i energjisë elektrike përsëri mbetet shumë i dobët përkundrejt ndryshimeve të papritura. Si rrjedhojë, çdo shpenzim kapital (*Capex*) i ri duhet të shqyrtohet me kujdes dhe financimi duhet të përfshihet si kapital i vet (*equity*) mundësisht në OSHEE (dhe më tej të transmetohet tek KESH nëpërmjet reduktimit të detyrimeve të prapambetura) për të zgjeruar bazën e tij të kapitalit dhe për të evituar projeksionet negative të përgjithshme financiare për periudhën 2015-2017, si dhe për të reduktuar

[1] Në të ardhmen e afërt, masat në vazhdim do të përfshijnë Ristrukturimin e Koorporatës dhe masat për kursimet në kosto tek çdo kompani.

ndikimin negativ të efekteve financiare nga rritja e tejskajshme e raportit të borxhit total mbi totalin e aseteve (leva financiare) në një mjedis tejet të paqëndrueshëm.

Duke pasur parasysh varësinë e sektorit energjetik nga kushtet meteorologjike, Qeveria nëpërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë do të përgatisë një Strategji të Zbutjes së Riskut dhe mekanizmat për të trajtuar efektet e varësisë nga moti dhe reduktimin e impaktit financiar në rast të prurjeve hidrike nën mesataren. Plani që pritet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave në fillim të vitit 2016 do të përfshijë dhe një sigurim nga risku për ngjarje të paparashikuara të motit bazuar në eksperiencën e rajoneve të ndryshme në botë. Mbështetja për këtë plan është përfshirë dhe në projektin e miratuar së fundmi me financim të Bankës Botërore.

Qeveria është e vetëdijshme se asnjë plan sado i mirë qoftë, nuk mund të ketë sukses po nuk u zbatua siç duhet. Në këtë drejtim Qeveria propozon:

a) Të fuqizojë menaxhimin e OSHEE-së nëpërmjet një kontrate menaxhimi të bazuar në rezultate, sikurse është përshkruar dhe mbështetur nëpërmjet Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë të financuar nga Banka Botërore për të siguruar që kostot, përmirësimi i humbjeve dhe objektivat e arkëtimeve të monitorohen dhe të jenë të arritshme, gjë që përbën dhe kyçin e suksesit të planit të rimëkëmbjes;

b) Të kthejë në shoqëri të vërteta tregtare të pavarura kompanitë shtetërore dhe të përmirësojë mirëqeverisjen dhe menaxhimin:

- duke fuqizuar përgjegjësinë e këshillave mbikëqyrës, në përputhje me përcaktimet e bëra në statute,
- duke fuqizuar llogaridhënien e shoqërive,
- duke përmirësuar transparencën dhe dialogun publik/privat,
- duke përfshirë drejtorë të pavarur joekzekutivë për të fuqizuar këshillat mbikëqyrës dhe ndihmuar të formulojnë politika dhe monitorojnë performancën e drejtimit sidomos në aspektin teknik dhe financiar;
- duke përshtatur praktika tregtare (si p.sh. maksimizimin e vlerës së kapitalit) në përputhje me kuadrin rregullator.

c) Të kryejë ndarjen formale të operacioneve në OSHEE, duke veçuar funksionin e shpërndarjes (rrjeti shpërndarës) nga furnizimi, sikurse parashikohet në ligjin e ri të sektorit të energjisë elektrike dhe duke e transferuar furnizuesin publik me shumicë dhe atë me pakicë së bashku me stafin, asetet dhe përgjegjësitë e lidhura me të, në këtë entitet të ri. Këto duhet të kryhen brenda periudhës 2015-2017 dhe sistemet tregtare të faturimit (*billing*) do të projektohen duke pasur parasysh këtë strukturë; dhe

d) Të përgatisë një OSHEE të strukturuar për të lejuar pjesëmarrjen e kapitalit privat sapo të rivendoset fitimi dhe bilancet financiare të jenë kthyer në gjendje të shëndoshë financiare, dhe të jetë vendosur një sistem të dhënash për të siguruar një veprimtari operacionale eficente dhe transparente në sektor.

Kombinimi i këtyre masave tregtare, financiare dhe strukturore: a) do të kthente sistemin nga një rrezik financiar, në të qëndrueshëm në fund të vitit 2018; ii) do të sillte investime private në sektor në mënyrë konkurruese dhe të hapur; dhe iii) do të përmirësonte sigurinë e furnizimit me energji elektrike duke përfshirë dhe forma të tjerë nga gjenerimi i energjisë nëpërmjet gazit.

II. PARATHËNIE

Sektori elektroenergjetik shqiptar funksionon si një sistem i ndërlidhur i aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike. Kërkesa për energji plotësohet kryesisht nga kompanitë publike – aktivitetet e prodhimit kryhen nga Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH); aktivitetet e rrjetit të transmetimit dhe operimit të tregut kryhen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), ndërsa aktivitetet e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë kryhen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ose OSHEE (ish-CEZ Shpërndarje).

Sektori është i monitoruar dhe pjesa më e madhe e tij e rregulluar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

Në tetor të vitit 2014 Qeveria rimori përsëri 100 për qind të aksioneve të ish-kompanisë "CEZ Shpërndarje" që i ishin dhënë përmes një procesi të privatizimit kompanisë çeke "CEZ as".

Me qëllim fillimin e procesit të liberalizimit të tregut, në vitin 2011, të gjithë konsumatorëve jofamiljarë të furnizuar në linjën e tensionit të lartë 220 kV dhe 110 kV, u detyruan të bëhen konsumatorë të kualifikuar dhe të zgjedhin furnizuesit e tyre, gjë që bëri që Shqipëria të ketë

aktualisht gjashtë konsumatorë të kualifikuar të tensionit të lartë (TL) me konsum vjetor prej 700 GWh në vit (14 për qind e kërkesës së përgjithshme të energjisë elektrike), duke e çliruar KESH-in nga detyrimi për t'i furnizuar ata me tarifa të rregulluara. Nga ana tjetër kapacitetet e disponueshme të gjenerimit të KESH u zvogëluan me 81 MW për shkak të privatizimit të Hidrocentraleve të Ulzës, Shkopetit, Bistricës 1, 2 dhe Lanabregas.

Në modelin e tanishëm të tregut, struktura e KESH-it është përgjegjëse për sigurimin e plotësimit të kërkesës për energji në Shqipëri për tregun me tarifa të rregulluara (duke përjashtuar energjinë e nevojshme për të mbuluar humbjet në rrjetin e shpërndarjes). KESH-i si kompani prodhuese e energjisë përfshin brenda saj edhe strukturën autonome "Furnizuesi Publik me Shumicë" (FPSH). Roli i FPSH-së është të blejë së pari energjinë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e hidrocentraleve të vegjël të energjisë (PVE) dhe prodhuesve të pavarur të energjisë (PPE) nëpërmjet çmimeve feed-in (të aprovuar nga ERE) e të përcaktuara në Marrëveshjet për Blerjen e Energjisë, dhe të energjisë elektrike të prodhuar nga KESH-i me tarifat e rregulluara të miratuara nga ERE për aq sa është e nevojshme për të përmbushur kërkesat e tregut të rregulluar; në rast se prodhimi i brendshëm nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e kërkesës së tregut të rregulluar, FPSH/KESH ka detyrimin të blejë energji shtesë nga importi nga tregje të parregulluara.

Sipas rregullave në fuqi, është vendosur që FPSH të blejë së pari energjinë e prodhuar nga PVE/PPE, më tej nga KESH/Gen, dhe më tej për të plotësuar nevojat të importojë energji.

Çështjet kryesore të identifikuara në segmentin e sektorit të prodhimit

- KESH-i është një kompani prodhuese dhe përfshirja e FPSH-së në strukturën e saj krijon barrë shtesë në planin e saj financiar për shkak të kostove të paparashikueshme të importit, të cilat nuk reflektohen plotësisht dhe në mënyrë të qartë në çmimin e saj të shitjes së energjisë, apo tarifave arbitrare të imponuara si rezultat i konflikteve të vazhdueshme me CEZ Shpërndarje mes viteve 2011-2014;

- Përfshirja e detyrimit për të blerë prodhimin e PPE-së nuk është reflektuar plotësisht në tarifën e shitjes, për shkak të prodhimit të paparashikuar (prodhimi i energjisë së HEC-eve varet nga prurjet e lumenjve) dhe/ose pezullimit të vendimeve për shkak të konfliktit ligjor me CEZ Shpërndarje në vitet 2012-2014.

- Mungesa e marrëveshjeve të shërbimit midis enteve (KESH, OST, dhe OSHEE) dhe e procedurave të veçanta në aspektin e sigurimit të pagesave të faturuara, ka krijuar hendeqe të paparashikueshme financiare që nuk mbulohen nga marrëveshje financiare me qeverinë.

- Mospagesat ose pagesat e vonuara nga konsumatorët kanë bërë që OSHEE të mos jetë në gjendje të paguajë tërësisht KESH dhe OST, duke sjellë vonesa të pagesave ndaj palëve të treta.

- Mospagesa e faturave të energjisë ndaj KESH nga OSHEE-ja për energjinë elektrike të konsumuar nga rrjeti për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes.

- Për arsyet e sipërpërmendura, KESH-i është detyruar të marrë hua nëpërmjet kredive afatshkurtra (*overdraft*) me një kosto të lartë.

- Pamundësia e KESH-it për të vepruar si një njësi tregtare (shitje dhe blerje me vendet fqinje), që ka kufizuar mundësinë e krijimit të fitimeve nga eksporti (KESH mund të shesë vetëm kur tregu i rregulluar nuk kërkon energji, apo në situata të prurjeve të jashtëzakonshme të ujit).

- Kushtet e paparashikueshmërisë atmosferike për vitet e ardhshme e kufizojnë KESH (furnizuesi i mundësisë së fundit) nga të qenit në gjendje të parashikojë saktësisht nevojat për import dhe për këtë arsye ta reflektojë atë në tarifën e cila miratohet nga ERE.

III. SITUATA AKTUALE E SEKTORIT TË ENERGJISË

Deficiti fiskal i Shqipërisë u rrit në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2013 me një përqindje të vlerësuar prej 6.2%. Deficiti i saj fiskal arriti mesatarisht 3,4% në periudhën mes viteve 2005 – 2012, me përjashtim të viteve 2008 dhe 2009, ku ai u përkeqësua ndjeshëm. Borxhi publik është rritur që nga kriza e vitit 2008.

Qeveria e mëparshme akumuloi detyrime buxhetore të konsiderueshme. Përveç detyrimeve të prapambetura të lidhura me punët publike, kishte detyrime buxhetore të prapambetura që lidhen me shëndetësinë (kryesisht medikamente), arsimin, ujin, rimbursimin e TVSH-së, tatimin mbi të ardhurat e koorporatës, faturat e energjisë elektrike dhe përfitimet sociale.

Stoku i detyrimeve të pashlyera u vlerësua në rreth 72.5 miliardë lekë (710 milionë US$), ose 5,3% e GDP-së. Presioni fiskal u rrit më tej gjatë mungesës së prodhimit të energjisë në vitin 2012, gjë që e detyroi qeverinë të sigurojë mbështetje financiare për KESH në formën e garancive sovrane për importet e energjisë. Qeveria e re kuptoi ekzistencën e këtyre detyrimeve të pashlyera dhe së bashku me një Program të FMN-së, ka zbatuar një strategji të qartë të shlyerjes së këtyre detyrimeve qysh në fillim të vitit 2014.

Sektori energjetik u zhyt më tej në një krizë financiare për shkak të privatizimit të dështuar të kompanisë së shpërndarjes që zotërohej me 76% të aksioneve të saj nga ana e kompanisë Çeke "CEZ as". Në tetor 2014 situata u zgjidh përmes rimarrjes së aksioneve nga ana e kompanisë shtetërore "OSHEE", e cila zotëron 100% të aksioneve.

Varësia nga reshjet si dhe furnizimi vetëm përmes hidrocentraleve të vendosura në kaskadën e lumit Drin në veri të vendit, shkakton paqëndrueshmëri në prodhimin e energjisë së furnizuar nga KESH. Kjo përbën një kërcënim në lidhje me parashikimin e importeve, duke sjellë kështu një rrezik për garantimin e furnizimit.

Aktualisht i gjithë prodhimi në vend varet nga hidrocentralet.

Një sektor energjie elektrike i varur nga paqëndrueshmëria e motit dhe me mungesë diversifikimi të prodhimit të tij.

Herë pas here nuk realizohet prodhimi i energjisë së parashikuar për shkak të luhatjeve të reshjeve, të cilat e pozicionojnë vendin në një situatë jo të favorshme për sigurimin e një furnizimi të besueshëm dhe të përballueshëm të energjisë, meqenëse ai ndikohet së tepërmi nga kushtet klimaterike rajonale. Sfida e furnizimit me energji elektrike të Shqipërisë ndikohet më tej nga kufizimet e kapacitetit transmetues të brendshëm dhe të jashtëm të lidhur me rajonin, si dhe nga sasia e pamjaftueshme e energjisë në dispozicion për furnizimin dhe tregtimin nga vendet fqinjë. Kjo situatë, përballë ngjarjeve ekstreme klimaterike, ndikon negativisht jo vetëm në Shqipëri, por edhe tek fqinjët e saj, duke shkaktuar një efekt negativ.

Për shembull, KESH-i bëri një vlerësim të një rasti më të keq mbi skenarin për importet e energjisë së nevojshme për të mbuluar tregun e rregulluar në vitin 2014, e vlerësuar në atë kohë ekuivalente me 1200 GWh, ose rreth 100 milionë US$. Në të vërtetë, KESH importoi 180 GWh (rreth 12 milionë US$), gjatë vitit për shkak të përmirësimit të kushteve klimaterike duke filluar nga muaji Mars si dhe të një menaxhimi më të mirë të rezervës ujore në kaskadën e lumit Drin.

Një vështirësi tjetër me të cilën sektori po përballet sot, është detyrimi financiar ndaj energjisë së blerë nga PPE-të. Ky detyrim është akumuluar nga shtimi i sasisë se prodhuar nga HEC-et private me më shumë se sasia e planifikuar dhe me tarifa shumë favorizuese blerjeje, shumë më të larta se çmimet e tregut të energjisë të miratuara nga ERE dhe me të cilën KESH bleu energjinë nga PPE-të, në vlerën e 9,3 lekë/KWh (66,4 euro/MWh) për periudhën 2012-2014. Vetëm për vitin 2014, kostoja e blerjes së energjisë elektrike nga SHPP/PPE, e pambuluar nga regjimi tarifor i FPSH/KESH, arriti në shumën rreth 2 miliardë lekë, e shkaktuar gjithashtu edhe nga mosristrukturimi i tarifave nga ERE mes viteve 2012-2014[2], për shkak të konfliktit të vazhdueshëm ligjor me CEZ Shpërndarje.

Performanca nën optimalen-mungesa e investimeve dhe menaxhimi i dobët nga ana e sektorit të shpërndarjes solli humbje të larta të energjisë, arkëtime më të ulëta dhe zvogëlim të kapitalit bazë të kompanisë shumë më tepër se sa ishte parashikuar në kohën e privatizimit.

Sektori i shpërndarjes përballet me një kombinim të sfidave që lidhen me energjinë e pafaturuar për shkak të mungesës së matësve, ose matësve të dëmtuar dhe vjedhjeve në sistem, si dhe me arkëtimet e pamjaftueshme për energjinë e faturuar nga familjet dhe bizneset (84% në vitin 2012), të cilat çuan në lindjen e problemeve financiare të ish-kompanisë private të shpërndarjes CEZ Shpërndarje. Tani Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përballet me vështirësi financiare dhe nuk është në gjendje të hyjë në tregjet e kapitalit për të kërkuar financime. Ndërsa vlera totale e kapitalit neto është më shumë se (-72) miliardë lekë.

Në kohën e privatizimit të rrjetit të shpërndarjes pritshmëria ishte që CEZ Shpërndarje do të zvogëlonte humbjet në 17% deri në vitin 2014 dhe

[2]Në dhjetor 2014 ERE miratoi me vendim ristrukturimin e tarifave të vitit 2013 dhe 2014 për PPV në përputhje me metodologjinë që ishte në fuqi e përcaktuar nga VKM-ja.

do të investonte rreth 200 milion US$ gjatë pesë viteve në sistemin e shpërndarjes. Privatizimi i kompanisë së shpërndarjes nuk funksionoi ashtu si pritej. Pranimi i nivelit të humbjeve dhe borxheve të këqija ndodhi më vonë sesa ishte parashikuar fillimisht dhe tarifat e shitjes me pakicë nuk u ristrukturuan në kohën e duhur. Arkëtimi i faturave nga institucionet buxhetore dhe jobuxhetore nuk u përmirësua dhe kompania e shpërndarjes, e menaxhuar nga ish-CEZ Shpërndarje, dështoi në zvogëlimin e nivelit të humbjeve teknike dhe jo teknike.

Më 21 janar 2013, ERE i hoqi licencën kompanisë "CEZ Shpërndarje" për shkak të mosrespektimit të detyrimeve të përcaktuara sipas kushteve të licencës dhe emëroi një administrator të përkohshëm publik për të drejtuar dhe administruar sistemin e shpërndarjes. Në këtë mënyrë, Qeveria mori përgjegjësinë dhe në thelb rrezikun fiskal për importet e energjisë të nevojshme për të kompensuar humbjet e energjisë. Si rezultat i kësaj, dhe në pamundësi për t'ju drejtuar bankave tregtare, për të importuar energji për mbulimin e humbjeve, KESH, si furnizues i mundësisë së fundit, mori kredi afatshkurtra nga bankat tregtare (*overdraft*) që në fund të vitit 2014 arritën në shumën 36.26 miliardë lekë (rreth 2.6% e GDP-së), prej së cilës 10.2 miliardë lekë nuk është i mbështetur me garanci sovrane. Interesi aktual i akumuluar mbi borxhin e njohur si hua afatshkurtër (*overdraft*) që KESH u pagoi bankave në vitin 2014 ishte 1.93 miliardë lekë.

Humbjet e energjisë u rritën në 51,1% në fund të vitit 2012 dhe me një mesatare vjetore 45% deri në fund të vitit 2013, ndërsa në vitin 2014 rezultuan me një përmirësim të rëndësishëm në më pak se 38%; shkalla e arkëtimit të faturave u ul nga 85% në vitin 2008, në 84,1% në vitin 2012, në 78,7% në vitin 2013, dhe u rrit deri në 84% në vitin 2014.

Duke pasur parasysh se ka pasur investime të pamjaftueshme kapitale nga ish-CEZ Shpërndarje dhe për shkak të mungesës së burimeve, Operatori i Shpërndarjes ka qenë në vështirësi për të importuar energji për të mbuluar humbjet, për të likuiduar detyrimet e prapambetura të tij ndaj kreditorëve tregtarë dhe për më tepër i pamundur të financojë një program të rëndësishëm për reduktimin e humbjeve. Kapitali i vet është negativ edhe pse borxhet që institucionet buxhetore dhe jobuxhetore i detyrohen OSHEE-së janë pothuajse sa dyfishi i deficitit korrent të kompanisë.

Për shkak të fakteve të përmendura më lart, si dhe për faktin se sektori i energjisë është shumë i ndërvarur, çdo ndryshim në sistem jep menjëherë një efekt zinxhir nga një shoqëri në tjetrën. Duke marrë parasysh se OSHEE është e pamundur që të gjenerojë të ardhura të mjaftueshme për të paguar kostot e saj, i gjithë sektori i energjisë është i ndikuar negativisht.

OSHEE e ka të pamundur të paguajë në mënyrë të vazhdueshme KESH, OST dhe/ose tregtarët e energjisë.

KESH dhe OST, duke qenë se janë me aftësi paguese të dobët për shkak të rivlerësimit të aseteve (aktiveve), mbeten kompani me aftësi jo likuiduese për shkak të mungesës së një niveli të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të pagesave që duhen bërë nga OSHEE. Kjo situatë është bërë e paqëndrueshme dhe përbën një rrezik të veçantë për KESH, meqë ai nuk mund të realizojë pagesat e kësteve të kredisë, të blejë energjinë elektrike nga PPE-të, dhe të importojë energjinë e nevojshme për të plotësuar kërkesat e brendshme të tregut të rregulluar.

Edhe pse u ndërtua termocentrali i Vlorës, kjo pasuri nuk është ende funksionale për shkak të problemeve të pazgjidhura teknike. Aktualisht KESH është në procesin e përzgjedhjes së konsulentit, i cili pritet t'i sigurojë atij një zgjidhje teknike për rregullimin e sistemit të ftohjes me ujë, si dhe kostot dhe afatin. Kur TEC-i të hyjë në funksionim në vitin 2018 (në rast se zgjidhja teknike e propozuar është ekonomikisht e shëndoshë dhe financiarisht e realizueshme), do të ketë kosto të larta të prodhimit të energjisë, pasi teknologjia e tij (CCGT) është projektuar për të punuar me karburante importi të shtrenjtë. Ky termocentral parashikohet të vihet në punë në të njëjtën kohë me përfundimin e projektit TAP dhe kjo linjë gazi do të mund të furnizojë TEC-in, i cili mund të punojë me kosto më të ulët. Ministria e Energjisë dhe Industrisë po negocion angazhimet financiare nga TAP-i për të lidhur termocentralin me tubacionin nga pika e tij e daljes në Fier.

Për shkak të vështirësive të bllokimeve të rrjetit që rrjedhin nga investimet e shtyra në rrjetin e transmetimit, OST-ja nuk mund të garantojë kapacitet të besueshëm të transmisionit për importet në rast të emergjencave.

Prandaj ka një nevojë urgjente për të realizuar investimet me objektiv zvogëlimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, dhe për të zgjeruar dhe përmirësuar rrjetin e transmetimit të OST-së, për të realizuar një furnizim të sigurt me energji.

Një tjetër faktor që ndikon në sektor ka qenë paqartësia e rregullatorit dhe kapaciteti i pamjaftueshëm institucional dhe ish-qeverisja e dobët, të cilat kanë çuar në kontrollin e dobët të zbatimit të rregullave të tregut, mungesën e disiplinës së pagesës dhe zbatimit të kontratave tregtare, arkëtimet e ulëta, nivelet e papërshtatshme të tarifave, pavarësinë e pamjaftueshme të rregullatorit, bllokimet periodike në marrjen e vendimeve për shkak të zgjedhjeve, mungesën e një operatori të efektshëm të tregut (një funksion i OSTsë) dhe të një kompanie të shpërndarjes të sektorit privat që nuk ishte në gjendje apo e gatshme për të ndërmarrë veprime dhe realizuar investimet e nevojshme për të reduktuar në mënyrë efektive humbjet teknike dhe jo teknike.

Duke pasur parasysh këto kushte, sektori nuk ka qenë në gjendje ta nxjerrë veten nga një "*modus operandi*" të menaxhimit të krizës, në një mënyrë të qëndrueshme operacionale.

Në këto kushte, Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) ka ofruar një kredi prej 150 milionë US$ që do të disbursohet gjatë pesë viteve të ardhshme, të orientuara kryesisht në sistemin e shpërndarjes. Duke marrë parasysh nevojat e larta të sektorit të energjisë, vetë projekti i financuar nga IBRD-ja nuk është i mjaftueshëm për të trajtuar dhe zgjidhur të gjithë boshllëkun financiar të trashëguar dhe atë aktual, i cili kërkon masa të mëtejshme shtesë dhe një reformë të thellë për të kapërcyer problemet e sektorit të energjisë.

Kapaciteti i dobët institucional dhe pasiguritë e Rregullatorit - Mungesa e pavarësisë së strukturës së shkuar rregullatore dhe pavendosmërisë së ish-qeverisë, kanë kontribuar në krijimin e një klimë jomiqësore me ish-sektorin e privatizuar të shpërndarjes, që në përgjithësi krijoi një shkallë të pasigurisë rregullatore, investime të kufizuara dhe mungesë të zbatimit të kontrollit të marrëveshjeve; kjo përfshiu mungesën e zbatimit të kontrollit të marrëveshjeve tregtare dhe miratimin e politikave tarifore të një tregu të lirë. Një situatë e tillë i përket të dyja palëve, ish-qeverisë dhe ish-Operatorit të Shpërndarjes, të cilët kanë përgjegjësinë për dështimin e menaxhimit të këtij sektori dhe sigurimin e furnizimit të sigurt me energji elektrike.

IV. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË REFORMËS NË ENERGJI ELEKTRIKE

Objektivi i përgjithshëm i reformës së propozuar të sektorit të energjisë elektrike është të sjellë qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të sektorit, me një fluks të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të parasë (*cash flow*), reduktimin e humbjeve të energjisë në nivelet e synuara, përmirësimin e arkëtimeve të energjisë së faturuar dhe zbatimin e pagesave të rregullta të faturuara midis shoqërive.

Objektivat specifikë

1. Mbyllja e hendekut financiar që sektori i energjisë elektrike prodhon çdo vit, brenda 5 viteve të ardhshme dhe transformimi i sistemit të energjisë nga një sistem që gjeneron borxhe në një sistem të vetëqëndrueshëm dhe me aftësi likuiduese.

2. Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm dhe të besueshëm të energjisë për të gjithë vendin pa ndërprerje të energjisë elektrike; përmirësimi i efikasitetit të sistemit të energjisë në sektorin e shpërndarjes duke zvogëluar humbjet dhe duke përmirësuar arkëtimet.

V. ZBATIMI I VEPRIMEVE PARËSORE[3]

Megjithëse u bë hapja e një llogarie bankare për të ardhurat e bllokuara për garancinë "*Escrow*" për kontrollin e zbatimit të detyrimeve minimale kontraktuale, përfshirë transaksionet financiare dhe teknike midis kompanive, pritet që OSHEE të jetë në gjendje të mbulojë 100% të blerjeve të saj të energjisë brenda vendit (KESH+PPE) duke filluar nga viti 2016.

Shuma ekzistuese e kredisë (*overdraft*) prej rreth 36.26 miliardë lekësh që KESH ka marrë ndaj bankave të nivelit të dytë për blerjen e energjisë si "furnizues i mundësisë së fundit", funksion i përcaktuar nga Modeli i Tregut, do të ristrukturohet. Ministria e Financave është duke ofruar mbështetjen e kërkuar për këtë proces që në fazën fillestare.

[3] Sipas Programit të Rimëkëmbjes së Sektorit të Energjisë të aprovuar në nëntor 2014

Tarifat e reja të miratuara nga ERE që do të aplikohen nga ana e Operatorit të Shpërndarjes për 2015 janë si më poshtë:

Tarifat e shërbimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2015

Niveli i tensionit	Çmimi (lekë/kWh)	Çmimi pik (lekë/kWh)
Konsumatorë në 35 kV	9.5	10.93
Konsumatorë në 20/10/6 kV	11	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli në 20/10/6 kV	7.1	8.17
Konsumatorë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjare	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndriçim shkallë, pompë, ashensor)	9.5	
Tarife fikse e shërbimit për leximin"zero"(lekë/muaj)	200	

Veprimet parësore që do të ndërmerren janë si më poshtë:

Subvencionimi drejtpërdrejt i klientëve në nevojë për diferencën e çmimit të ri në krahasim me çmimin e fashës deri 300 kWh. Sot vlerësohen të jenë maksimumi 214,000 konsumatorë në këtë kategori. Qeveria ka pranuar përgjegjësinë për të subvencionuar familjet në nevojë për çdo ndryshim në çmim për sasinë e 300 kWh. Ajo do të subvencionojë faturat e energjisë në një shumë 1.7 miliardë lekë në vitin 2015 dhe me tej do t'i përditësojë ato sipas ristrukturimit të tarifave të rregulluara.

Borxhet, të vlerësuara në më pak se 6.2 miliardë lekë deri në fund të vitit 2014 (përfshirë HEC-in e Ashtës), që FPSH i detyrohet PPE-ve do të paguhen brenda vitit 2015, duke shfrytëzuar brenda tremujorit të parë, rritjen e pagesave që OSHEE-ja do të bëjë ndaj KESH/FPSH-së për borxhet, pagesa të cilat po rriten së fundmi për shkak të masave të reja të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare dhe OSHEE, si dhe nëpërmjet pagesave të detyrimeve që institucionet buxhetore dhe jobuxhetore i detyrohen OSHEE-së për energjinë elektrike gjatë viteve.

Deri në fund të vitit 2019 arkëtimet do të realizohet në masën 95% nga pagesat e faturave të energjisë nga konsumatorët familjarë, jofamiljarë, institucionet dhe kompanitë publike.

Duke filluar nga viti 2015 të gjitha pagesat e faturave të energjisë të institucioneve shtetërore të financuara nga Qeveria do të realizohen nga zbatimi i një sistemi me mekanizëm detyrimi.

Pagesa e të gjithë shumës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, që në total arrin vlerën prej 210 milionë US$, që KESH, OSHEE dhe OST i kanë borxh buxhetit të shtetit, brenda vitit 2015. Do të merret në shqyrtim një rishikim i mundshëm i shumës së TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin, pasi shuma aktuale e TVSH-së dhe tatim fitimit është e lidhur me faturat e shitjes midis kompanive. Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe të tre kompanitë janë duke punuar me Ministrinë e Financave në mënyrë që të bëjnë një propozim ligjor për të sistemuar (*net-off*) këto detyrime dhe për të pastruar pasqyrat financiare. Ky proces është planifikuar të realizohet brenda tremujorit të parë të vitit 2015.

Reduktimi i humbjeve në sektorin e shpërndarjes, me një mesatare prej 5% ulje në çdo vit, nga niveli prej 37.6% që është aktualisht, në një nivel prej 14% deri në vitin 2019.

Rekomandimet e studimit që do të kryhet për zbutjen e efekteve të shkaktuara nga ndryshimet klimaterike që ndikojnë në kushtet hidrologjike të kaskadës së KESH-it, do të zbatohen përgjatë vitit 2015 dhe në vazhdim.

Sigurimi i furnizimit me energji do të përmirësohet duke diversifikuar portofolin e prodhimit, përmes fillimit të hyrjes në punë të TEC-it të Vlorës në rastet e emergjencave, dhe stimulimin e hidrocentraleve rajonale të furnizimit me energji.

Miratimi i ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike, si dhe finalizimi i Modelit të ri të Tregut do të na lejojë të ulim rrezikun e KESH-it për shkak të ndikimit financiar që ai ka nga kushtet hidrologjike. Modeli i ri i Tregut duhet të miratohet dhe të zbatohet në mënyrë paralele dhe si pjesë përbërëse e ligjit të ri për sektorin e energjisë elektrike.

VI. VEPRIMET/AKTIVITETET E PLANIT TË RIMËKËMBJES FINANCIARE

Është e qartë se ekziston një nevojë urgjente për të mobilizuar fonde për të:

- injektuar me shpejtësi likuiditete në sistem për të siguruar importet në kohë nga të dy kompanitë si KESH dhe OSHEE;
- pastruar pasqyrat financiare të sektorit, me qëllim rivendosjen e qëndrueshmërisë, likuiditetin operacional dhe kreditimin e pjesëmarrësve të tregut;
- rivendosur praktikat tregtare dhe marrëdhëniet me furnizuesit dhe huadhënësit për të mbështetur operacionet dhe për të ofruar një qasje në tregjet e brendshme financiare.

Plani i propozuar për Rimëkëmbjen Financiare të Sektorit të Energjisë përqendrohet në tri shtylla kryesore: rritjen e efektivitetit operacional, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe vendosjen e mekanizmave të kontrollit dhe drejtimit të kompanive, dhe qëndrueshmëri financiare, pa harruar dhe përmirësimet në infrastrukturë.

Adresimi i humbjeve të mëdha të energjisë dhe financimi i një deficiti agregat të projektuar me rreth 60 miliardë lekë është thelbësor dhe i vonuar. Kjo situatë është e paqëndrueshme dhe mund të përmirësohet vetëm me zbatimin urgjent të një programi të plotë veprimesh për një periudhë të gjatë kohore, duke përfshirë përmirësimin e arkëtimeve në mjete monetare, uljen e humbjeve, ekipe të forta dhe me përvojë menaxhuese në secilën ndërmarrje, ristrukturimin e tarifave të shitjes me pakicë në një nivel që pasqyron koston, si dhe rishikimin e modelit të tregut, për të lehtësuar migrimin progresiv të konsumatorëve të tensionit të mesëm nga tregu i rregulluar drejt një tregu energjie, i cili operon mbi parimet tregtare.

Zgjidhja e mosmarrëveshjes me kompaninë CEZ a.s. është finalizuar tashmë dhe pronësia e OSHEE i është kthyer Qeverisë Shqiptare në Tetor të vitit 2014. Kjo zgjidhje përbën një progres pozitiv dhe një hap të madh drejt zbatimit të planit të hershëm të Bankës Botërore për rimëkëmbjen dhe reformat në sektorin e energjisë. Megjithatë, kjo përjashton mundësisë e dështimit në riorganizimin e sektorit dhe duke qenë se mungon një marrëveshje, Qeveria duhet të ulet të diskutojë me kreditorët për zgjatjen e kohës. Shqipëria është një vend që respekton (njeh) borxhin e saj dhe detyrimet kontraktuale. Duhet parë me kujdes ky detyrim.

Është e qartë që KESH-it i është ngarkuar barra e tarifave që nuk reflektonin kostot në të shkuarën për shkak të kolapsit të privatizimit të OSSH (tani OSHEE). Efektivisht KESH është përdorur për të financuar importet e kompanisë OSHEE që nga privatizimi i tij në vitin 2008. Pas rivlerësimit të aseteve të kompanisë në vitin 2009, u konstatua paaftësia e saj në pagesat e detyrimeve ndaj KESH. Kjo barrë çoi në vonesat e detyrimeve ndaj PPE-ve, taksave, TVSH-së, të sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve të tjera ndaj Qeverisë Shqiptare, si edhe duke arritur në limitet maksimale të borxheve afatshkurtra (*overdraft*) të vendosura nga bankat e nivelit të dytë. Në fund të vitit 2014, u arrit limiti i marrjes së kredive afatshkurtra dhe u shteruan kapacitetet e kompanisë për të siguruar mbështetje të mëtejshme për sektorin, pa të cilat paraqitet një kërcënim serioz për sigurinë e furnizimit me energji dhe stabilitetit fiskal të vendit. Qeveria Shqiptare e ka identifikuar këtë rrezik dhe është e vendosur të aplikojë masa emergjente për ta kthyer këtë sektor dhe të gjithë sistemin energjetik drejt një sistemi me zhvillim të qëndrueshëm.

Për më tepër, OSHEE nuk është në gjendje të hyjë në tregjet e brendshme financiare për shkak të paaftësisë paguese të saj dhe, siç u përmend më sipër, mbijeton vetëm duke i kaluar detyrimet e saj KESH dhe Ministrisë së Financave, duke shtyrë pagesat e borxhit, pagesat për blerjen e energjisë nga KESH, TVSH-në, tatimin mbi të ardhurat si dhe sigurimet shoqërore. Me krijimin e një llogarie bankare (*escrow*), në pajtim me përcaktimet e marrëveshjes së Huas me Bankën Botërore për Projektin e Rimëkëmbjes së Energjisë, paaftësia paguese e OSHEE-së ndaj KESH do të zvogëlohet ndjeshëm. Megjithatë, një analizë e detajuar, bazuar në planet e biznesit 2015 (i amenduar) për secilën prej kompanive,

tregon se sektori mund të financohet brenda paketës ekzistuese të rënë dakord me FMN-në dhe të transformohet nëpërmjet ndërmarrjes së hapave agresive për të përmirësuar efikasitetin operacional, kapacitetin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare.

Qeveria shfuqizoi strukturën e tarifave me dy fasha për konsumatorët familjarë dhe vendosi një tarifë që pasqyron kostot për të gjithë kategoritë e konsumatorëve, duke filluar nga janari i vitit 2015. Tarifa mesatare e ponderuar me pakicë u ristrukturua në një tarife unike prej 9.5 lekë/kWh, duke sjellë një përmirësim prej me 9.1% dhe tarifa mesatare nga 9,8 lekë / kWh u bë në 10,7 lekë/kWh, për shkak të rritjes së tarifës për konsumatorët jofamiljarë në masën 15%. Gjithashtu, Qeveria mbështeti fuqishëm aksionet në terren për zbatimin e programit për reduktimin e vjedhjes së energjisë elektrike dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimeve. Rezultatet deri tani janë inkurajuese, pasi janë reduktuar humbjet e energjisë elektrike në total nga 45% në 37.6 %, si dhe është rritur niveli i arkëtimeve nga 78% në 90%, duke përfshirë dhe arkëtimet e prapambetura gjatë vitit 2014.

Qeveria është e angazhuar tërësisht për të përmirësuar efikasitetin, kapacitetin institucional dhe qëndrueshmërinë financiare duke implementuar masat e rëndësishme të mëposhtme. Për të qenë efektive, të gjitha hapat e këtij plani veprimi duhet të trajtohen me të njëjtën rëndësi. Këto veprime përfshijnë:

a) Përmirësimin e humbjeve joteknike dhe rritja e nivelit të arkëtimeve me mbështetjen e Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë. Arritja në kohën e duhur e objektivave operacionale të rëna dakord (në përqindje) është çelësi i kthesës së sektorit të energjisë, duke minimizuar mbështetjen e kërkuar nga aksionarët, konsumatorët e energjisë dhe taksapaguesve;

	Humbjet teknike (%)	Humbjet joteknike (%)	Niveli i arkëtimeve (%)
2014	17	20.6	90
2015	21.04	10.76	91
2016	17	9	92
2017	15	6	93
2018	15	4	95
2019	13	2	95
2020	6	2	95

b) Zbatimin në terma afatshkurtër dhe afatmesëm të Planit të Rimëkëmbjes Financiare, përfshirë ndër të tjera:

- Heqjen e sistemit me fashë dytarifor dhe mbajtjen e një strukture tarifore me nivele me një mesatare të ponderuar prej 10.7/kWh, të indeksuar me kostot operacionale dhe kursin e këmbimit, subjekt i rishikimit periodik. Grupet e prekuara nga ky ndryshim janë identifikuar dhe do të subvencionohen nga buxheti i shtetit përmes Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
- Futjen e kufizimeve të një buxheti rreptësisht të kontrollueshëm dhe masave për kontrollin e kostove për të përmirësuar efikasitetin, produktivitetin dhe sigurimin e likujditeve të nevojshme veçanërisht gjatë katër viteve të ardhshme;
- Shlyerjen në dy faza të borxheve ndërmjet kompanive në vlerën e 4.4[4] miliardë lekë/kWh dhe 8.0 miliardë lekë sipas marrëveshjeve respektive të DPL-së në vitin 2014 dhe 2015 në zbatim të VKM nr. 126 datë 11.2.2015, e cila konsideron si limit të sipërm 9.0 miliardë lekë;
- Shlyerjen e borxheve ndaj PPE-ve, brenda vitit 2015;
- Të gjitha institucionet buxhetore dhe jobuxhetore pas kësaj do të jenë subjekte të mekanizmave të detyrimit brenda departamentit të thesarit për të siguruar pagesë në kohë për të gjitha faturat e energjisë së konsumuar;
- Rifinancimin/riprogramimin/ristrukturimin e borxhit të kushtueshëm kur është e mundshme (sidomos shumave të tërhequra si overdraft) për të ulur shërbimin e borxhit të KESH-it dhe për të përmirësuar fluksin e parasë (*cash flow*);
- Shpenzimet kapitale do të shqyrtohen me kujdes nga ana e këshillave mbikëqyrës, si dhe ministria e linjës dhe do të kufizohen vetëm me zërat thelbësorë që janë konsistente me sigurinë e sistemit, programin e dakortësuar të reduktimit të humbjeve dhe që sjellin të ardhurat me të mëdha në terma afat shkurtër;
- Miratimi i ligjit të energjisë elektrike të paraqitur në Parlament dhe së bashku me të Modeli i ri i Tregut të Energjisë i cili mundëson fillimin e liberalizimit të mëtejshëm të tregut,

[4] Duke përfshirë insitucionet buxhetore dhe jobuxhetore.

lirimin e KESH nga roli i FPSH dhe për pasojë krijimin e mundësisë për të tregtuar lirshëm energjinë shtesë përtej mbulimit të klientëve tarifor;

- Miratimi i amendimeve në ligjin për energjitë e rinovueshme dhe miratimi i Planit Kombëtar të Energjive të Rinovueshme i cili do të bëjë të mundur një planifikim të qartë të kapaciteteve të reja prodhuese, diversifikimin e burimeve, si dhe kontrollin më të mirë të kostove të energjisë tashmë të mbuluara nga regjimi tarifor.

- Përcaktimi i tarifave të arsyeshme dhe në përputhje me nivelet tarifore të aprovuara nga ERE për prodhuesit e pavarur të energjisë, duke eliminuar krijimin e borxheve të reja si rezultat i furnizimit me energji elektrike përtej niveleve të miratuara në tarifë.[5]

- Miratimin nga ana e ERE-s të tarifave të aksesit në rrjet sipas nivelit të tensionit për të mundësuar daljen në treg të klientëve të lidhur në tension të mesëm 35/20/10/6 kV.

- Sigurimin e një raporti të borxhit me kapitalin e vet të OSHEE, të financuar nga buxheti qendror e garantuar nga Ministria e Financave dhe e përdorur për të paguar borxhet e energjisë ndaj KESH dhe deficitin e projektuar financiar të tij, deri në kufirin e hendekut negativ të projektuar të krijuar gjatë viteve 2015-2017 nga humbjet dhe arkëtimet; dhe

- KESH parashikohet të jetë në gjendje të eksportojë energji gjatë disa viteve të ardhshme. Rrjedhimisht, Qeveria propozon që të mbajë të rezervuar shumën e 30 milionë US$, pjesë e kredisë së Bankës Botërore të alokuar për importet e KESH, derisa të jetë hartuar programi i zbutjes së rrezikut të sigurisë të burimeve hidrike.

c) Mbajtjen e tarifave të përshtatshme që reflektojnë kostot për furnizimin, transmetimin, shpërndarjen dhe shitjen e energjisë. Duhet të theksohet se këto tarifa përfshijnë vetëm humbjet teknike dhe nuk pasqyrojnë humbjet jo teknike që janë rezultat i vjedhjes së energjisë nga një numër i madh konsumatoresh në kurriz të konsumatorëve të tjerë;

d) TEC-i i Vlorës do të rikomisionohet në pritje të çmimeve më të ulëta të naftës bruto dhe/ose të furnizimit nga gazi i projektit TAP, duke e çuar në një strukturë me kosto të ndryshueshme me të ulët.

e) Përmirësimin e administrimit të kompanive, transparencës dhe pavarësisë së rregullatorit për të vepruar në interes të publikut dhe vetëm në interes të publikut; dhe

f) Reformimin e modelit të tregut dhe të kuadrit ligjor/rregullator për kalimin progresiv të konsumatorëve të tensionit të mesëm nga tregu i rregulluar[6] në tregun e hapur të energjisë si dhe transferimin e strukturës së FPSH.

Impakti i përgjithshëm financiar i këtyre veprimeve paraqitet në aneks I (a) dhe përmblidhet në fig. 1 më poshtë. Kjo tregon se kërkesat e huamarrjes janë të menaxhueshme prej periudhës aktuale deri në 2017, të llogaritura në 5.5, 5.2 dhe 3.7 miliardë lekë para se sektori të gjenerojë të ardhura pozitive dhe të fillojë rrugën e gjatë për tu shndërruar në një sektor të shëndosh financiar.

Figura I tregon madhësinë dhe kohëzgjatjen e financimit shtesë që do të duhet në rastin kur: a) Projekti i Rimëkëmbjes së Energjisë do të zbatohet sikurse është planifikuar; dhe b) shpenzimet kapitale do të mbahen të kontrolluara (që do të thotë 60% e atij të propozuar në planin e biznesit); dhe c) kushtet klimaterike qëndrojnë në ose mbi nivelin e kushteve mesatare afatgjata.

Në këtë skenar, pritet që sektori të transformohet tërësisht gjatë katër viteve të ardhshme. Megjithatë, duket qartë se overdrafti për sektorin në tërësi do të rritet nga niveli aktual 36.26 miliardë lekë në 47.3 miliardë lekë deri në fund të vitit 2017. Kjo kërkesë shtesë tejkalon gatishmërinë e bankave të brendshme për të kredituar fonde shtesë dhe pa ndërhyrjet e propozuara më poshtë, sistemi duket qartësisht i paqëndrueshëm.

[5] Këshilli i Ministrave me VKM nr. 125, datë 11.2.2015, miratoi metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do tu paguhen prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike nga hidrocentralet, ndërkaq ERE me vendimin nr, 27, date 16.02.2015, përcaktoi tarifën për vitin 2015 për prodhuesit e pavarur të energjisë në vlerën 7.636 l/kwh.

[6] Megjithatë kostoja e përfitimit të saj duhet të shqyrtohet me kujdes për arsye të subvencionit të qenësishëm të konsumatorëve familjarë nga konsumatorët tregtarë pas heqjes së tarifës me fashë.



Qartësisht plani nuk është pa rrezik, veçanërisht në lidhje me tri fusha të veçanta, të cilat përfshijnë: raporti i borxhit total me vlerën totale të aseteve (i levës financiare), varësia nga ndryshueshmëria e motit dhe plani i zbatimit.

Në skenarin e parë duhet të theksohet se me dekapitalizimin sistematik të sektorit, vlerësohet një raporti i lartë i levës financiare, siç tregohet edhe më poshtë në tabelën financiare të konsoliduar me nr. I, (pa përfshirë OST). Raporti i borxhit ndaj kapitalizimit të kësaj madhësie jo vetëm që shkakton një pjesë të madhe të kostove të shërbimit të borxhit sipas kuadrit rregullator ekzistues, i cili bazohet në një normë kthimi prej vetëm 60%, por edhe përbën një rrezik për ndonjë kolaps (shok) financiar dhe së bashku me modelet e përkeqësimit të kushteve të disfavorshme të motit (në mungesë të ndonjë masë lehtësuese) garantojnë pothuajse mundësitë e përballjes me një krizë financiare brenda disa viteve të ardhshme. Çdo lloj financimi i ri duhet të paraqitet si një formë kapitali i vet dhe veçanërisht në OSHEE (dhe më tej të transmetohet tek KESH nëpërmjet reduktimit të detyrimeve të prapambetura) për të zgjeruar bazën e tij të pronësisë dhe evituar projeksionet negative financiare të agreguara për periudhën 2015-2017 dhe reduktimin e impaktit negativ nga rritja e tejskajshme e leves financiare në një mjedis tejet të paqëndrueshëm.

Tabela1: Leva Financiare e Agreguar (OSHEE)[7]

	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Borxhi – KESH	68,286	72,079	72,366	72,399	69,547	65,069
-OSHEE	11,107	9,103	13,370	17,023	17,079	16,021
Totali i borxhit	79,370	81,200	85,736	89,776	86,536	81,090
Kapitali i vet- KESH	74,685	73,597	70,690	66,187	62,619	58,836
-OSHEE	(74,002)	(71,372)	(71,134)	(65,625)	(55,767)	(43,418)
Totali i kapitalit të vet	683	2,224	(444)	558	6,852	15,418
Raporti Borxh/Kapitalizim(%)	99.1	97.3		99.4	92.7	84.0

[7] Duke përjashtuar transaksionet mes kompanive dhe përshirë mbështetjen nga Qeveria për TVSH dhe pagesat për sigurimet shëndetsore dhe shoqërore

Sipas skenarit të dytë, kërkesa për huamarrje e KESH dhe OSHEE do të rritet përtej overdraftit aktual, siç tregohet në dy kurbat e ndara kumulative në fig. II dhe III më poshtë, e cila duket qartësisht e paqëndrueshme. Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet rregullimit të transfertave ndërmjet kompanive, për të garantuar që të dy kompanitë të jenë të financuara në mënyrë të kënaqshme; pasi mund të ndodhe që OSHEE të kërkojë të reduktojë detyrimet e papaguara ndaj KESH në një periudhë shumë më të shkurtër nga ajo që është planifikuar aktualisht.

Fig. II KESh - Projected Overdraft Balance



Fig. III OShEE Projected Funding Requirement



Ajo që vihet re nga dy kurbat e paraqitura me sipër është se me anë të një disipline të fortë financiare dhe mbikëqyrje të fuqishme të komponentëve të planit të rimëkëmbjes financiare, KESH do të jenë në gjendje:

- të mbetet brenda normave të kredisë ekzistuese dhe të fillojë të paguajë borxhin afatshkurtër që është akumuluar, në një periudhë

shumë më të shkurtër nga ajo që është planifikuar, nga 2018 e tutje;

- të demonstrojë se sektori është financuar plotësisht dhe në përputhje me kushtin e bërjes efektiv të Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë; dhe

- të mbështesë tarifat e rregulluara në nivele të përballueshme për një periudhë të parashikueshme në të ardhmen. Duhet theksuar se këto llogaritje bazohen në kushte mesatare klimaterike afatgjata dhe për këtë arsye mbeten të varura ndaj kushteve të pafavorshme hidrologjike, në mungesë të një strategjie të shëndoshë të menaxhimit të rrezikut.

Projeksionet financiare të kompanisë, që dalin nga të dhënat e konsoliduara të paraqitura në aneksin I (a-c) tregojnë se me përjashtim të vitit 2015, KESH do të plotësojë kushtin e marrëveshjes së kredisë për strukturën e shërbimit të borxhit dhe kapitalit.

Për më tepër KESH është në diskutime me bankat për të ristrukturuar pjesën kryesore të overdrafteve, duke i kthyer ato në kredi afatmesme për të reduktuar më tej kostot e tij të kapitalit, përmirësuar kërkesat e shërbimit të borxhit dhe të plotësojë kushtin e marrëveshjes së kredisë për shërbimin e borxhit.

Sipas skenarit të tretë, Qeveria është e vetëdijshme se asnjë plan, sado i mirë qoftë, nuk mund të ketë sukses po nuk u zbatua siç duhet. Në këtë drejtim Qeveria propozon:

a) Të përgatisë një strategji menaxhimi kosto efektive të riskut dhe mekanizmin për të trajtuar varësinë nga kushtet e motit, si dhe të ulë impaktin potencial financiar të kushteve nën mesataren hidrologjike;

b) Të fuqizojë menaxhimin e OSHEE-së nëpërmjet një kontrate menaxhimi të bazuar në rezultate, sikurse është përshkruar dhe mbështetur nëpërmjet Projektit të Rimëkëmbjes së Energjisë të financuar nga Banka Botërore për të siguruar që kostot, përmirësimi i humbjeve dhe objektivat e arkëtimeve të monitorohen dhe të jenë të arritshme, gjë që përbën dhe kyçin e suksesit të planit të rimëkëmbjes;

c) Të kthejë në shoqëri të vërteta tregtare të pavarura kompanitë shtetërore dhe të përmirësojë mirëqeverisjen dhe menaxhimin:

- duke fuqizuar përgjegjësinë e këshillave mbikëqyrës, në përputhje me përcaktimet e bëra në statute;

- duke fuqizuar llogaridhënien e shoqërive;

- duke përmirësuar transparencën dhe dialogun publik/privat;

- duke përfshirë drejtorë të pavarur joekzekutivë për të fuqizuar këshillat mbikëqyrës dhe ndihmuar të formulojnë politika dhe monitorojnë performancën e drejtimit sidomos në aspektin teknik dhe financiar;

- duke përshtatur praktika tregtare (si p.sh. maksimizimin e vlerës së kapitalit) në përputhje me kuadrin rregullator.

d) Të kryejë ndarjen formale të operacioneve në OSHEE, duke veçuar funksionin e shpërndarjes (rrjeti shpërndarës) nga furnizimi, sikurse parashikohet në ligjin e ri të sektorit të energjisë elektrike dhe duke e transferuar furnizuesin publik me shumicë dhe atë me pakicë se bashku me stafin, asetet dhe përgjegjësitë e lidhura me të, në këtë entitet të ri. Këto duhet të kryhen brenda periudhës 2015-2017 dhe sistemet tregtare të faturimit (*billing*) do të projektohen duke pasur parasysh këtë strukturë; dhe

e) Të përgatisë një OSHEE të strukturuar për të lejuar pjesëmarrjen e kapitalit privat sapo të rivendoset fitimi dhe bilancet financiare të jenë kthyer në gjendje të shëndoshe financiare, dhe të jetë vendosur një sistem të dhënash për të siguruar një veprimtari operacionale eficente dhe transparente në sektor.

Më tej, një projekt i dytë në këtë sektor mund të jetë i nevojshëm në vitet e ardhshme për të përfunduar ristrukturimin financiar të sektorit dhe për t'i realizuar këto reforma sektoriale në një masë të plotë. Banka Botërore është e vendosur të koordinojë me bashkësinë ndërkombëtare dhe të mobilizoje burimet aty ku i nevojiten sektorit, brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe ta vendosë atë në një bazë të qëndrueshme për të garantuar sigurinë e furnizimit. Përpjekjet për reforma serioze në sektorin e energjisë janë të nevojshme për të zvogëluar rreziqet për buxhetin, si dhe rritjen e krijuar nga reduktimi dhe ndërprerjet e energjisë në të kaluarën.

VI. Risqet dhe pasiguritë

Megjithatë ekzistojnë risqe të përgjithshme të zbatimit të planit. Nevojiten ndryshime në strukturën dhe legjislacionin e sektorit për të përmirësuar efikasitetin dhe për të shkuar drejt një tregu të parregulluar, të cilat përfshijnë:

1. Çështjet financiare. Madhësia dhe synimi i financimit shtesë që duhet, varet nga kushtet hidrologjike mesatare, kurset e këmbimit dhe përqindjet e interesit global, të cilat janë në një masë të madhe jashtë kontrollit të Qeverisë.

2. Rezistenca e publikut për të ndryshuar. Ristrukturimi i tarifave, ndjekja penale e vjedhësve dhe ushtrimi i kontrollit për detyrimin për të paguar nëpërmjet ndërprerjes së furnizimit mund të ndeshë në rezistencën e publikut ndaj iniciativave për përmirësim. Kjo do të merret në konsideratë me anë të fushatës së ndërgjegjësimit të publikut.

3. Çështjet legjislative. Ligji i ri për sektorin e energjisë elektrike duhet të miratohet në mënyrë që të zbatohen disa nga reformat e parashikuara.

4. Sistemi gjyqësor (gjykata). Sistemi gjyqësor duhet të jetë i gatshëm të zbatoje dënimet për vjedhjen e energjisë elektrike.

5. Prokurorët. Prokurorët duhet të jenë më të vendosur në dërgimin në gjykata të vjedhësve të energjisë.

6. Aftësia e OSHEE-së për të shkarkuar dhe çuar për ndjeke penale punonjësit e korruptuar. Menaxhimi duhet të ketë vullnetin për të shkarkuar dhe dërguar për ndjekje penale punonjësit që mundësojnë vjedhjen e energjisë elektrike apo keqmenaxhimin e parave të arkëtueshme. Nuk duhet të ushtrohet presion politik ndaj menaxhimit për të mbajtur punonjës të pandershëm. Gjykatat nuk duhet të përdoren si një mënyrë për punonjësit e shkarkuar për tu rikthyer në punë.

7. Subvencionimi social për klientët në nevojë. A do të financohet për vitet në vazhdim nga buxheti i Qeverisë shuma prej 1.7 miliardë lekë si kompensim i energjisë elektrike të familjeve në nevojë?

8. Reduktimi i çmimit të kontratës për PPE-të. Mundësia për të zbatuar reduktimin e çmimeve të diskutuara më parë mund të rezultojë në raste të vecanta në mosmarreveshje ligjore dhe vonesa.

9. Kapacitetet menaxhuese të kompanisë së shpërndarjes. A do të ketë vullnetin dhe do të jetë në gjendje menaxhimi aktual i OSHEE-së të zbatojë uljen e humbjeve dhe përmirësimin e nivelit të arkëtimeve, në mënyrë aq kërkuese sa e supozon parashikimi? Në vitin 2015 pritet që kompania e kontraktuar për menaxhim të sigurojë praktika të shëndosha të menaxhimit dhe deri diku të izolojë kompaninë nga presioni nga jashtë saj.

10. Reduktimi i numrit të konsumatorëve pa matës. Është kritike që matësit e rinj të blihen dhe instalohen të sigurt në një kohë sa më shpejt të jetë e mundur për të reduktuar humbjet joteknike.

11. Rritja e çmimeve për njësitë tregtare dhe industriale. Plani supozon që konsumatorët e rrjetit 35kV dhe 10kV të lënë tarifat e rregulluara dhe të paguajnë çmimet bazuar në çmimet e importit. Kjo do të rezultojë në një rritje për disa konsumatorë duke i ekspozuar ata ndaj rreziqeve që do të paraqesin çmimet rajonale të energjisë në të ardhmen. A do të ushtrojnë ata presion politik për të mbetur si konsumatorët normal?

12. Çmimet rajonale të energjisë. Duke pasur parasysh faktin se Shqipëria duhet të importojë energji për të plotësuar nevojat hidrike, vendi është i ekspozuar ndaj rreziqeve të trashëguara të tregjeve rajonale të energjisë.

13. Situata me TEC-in e Vlorës. Parashikimi supozon që TEC-i Vlorës do të rehabilitohet dhe do të vihet në shërbim. Kjo do të varet nga çmimet e tregut botëror të karburantit, të cila janë deri diku përtej kontrollit të KESH-it.

14. Borxhi i konsumatorëve Buxhetorë. Kompensimi i borxheve do të likuidohet nga institucionet buxhetore brenda buxhetit të tyre të miratuar nga parlamenti duke përdorur mekanizëm detyrimi.

15. Çështjet që lidhen me taksat. Administrata fiskale është një faktor i rëndësishëm lidhur me mbledhjen e borxheve dhe faturave aktuale nga konsumatorët privatë, meqenëse ata mund të kontrollojnë nëse të gjitha faturat e energjisë elektrike të përfshira në bilancin vjetor financiar të tyre janë likuiduar, duke shmangur mospagesën e detyrimit të energjisë, si një e mirë publike, dhe ndërkohë të zvogëlojnë fitimin dhe kështu me radhë të paguajnë më pak tatim mbi fitimin për aktivitetet e tyre.

VII. PLANI I VEPRIMIT PER ZBATIM



Aneksi I (a)

Sektori i Energjitik Shqiptar (përjashtuar OST)
Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave

(Lek/milionë)

	Aktual	Parashikuar				
	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Shitje OST-së (Për humbjet në transmetim)	*161*	*268*	*254*	*254*	*254*	*254*
Konsumatorët në Shitje me pakicë	*37,080*	*42,250*	*42,340*	*45,479*	*49,097*	*49,050*
Institucionet Buxhetore	*5,362*	*6,735*	*7,226*	*7,741*	*8,177*	*8,634*
Eksportet	*257*	*11*	*2,646*	1540	*2,232*	*1,929*
Përdoruesit Industriale	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Shitjet e Energjisë	42,860	49,264	52,467	55,015	59,760	59,866
Të ardhura të tjera	3,730	943	944	944	944	944
Dëm ekonomik	0	0	0	0	0	0
Totali i të Ardhurave Operative	**46,590**	**50,207**	**53,411**	**55,959**	**60,704**	**60,810**
Shpenzimet Operative:						
Blerje Energjie nga Importi	20,779	14,690	13,571	11,112	9,307	7,535
Blerje Energjie nga Private&Koncesion	8,138	8,135	11,879	13,333	13,842	13,842
Blerje Energjie nga DSO						
Blerje Energjie nga WPS						
Blerje Energjie nga hidrocentrale të tjera	205	225	225	225	225	225
Blerja e energjisë nga familjarët	8,343	8,360	12,104	13,558	14,067	14,067
Personeli/ Pagat	4,454	5,913	5,963	6,016	6,073	6,133
Karburant	0	0	0	0	0	0
Mirëmbajtje	884	2,755	2,755	2,755	2,755	2,755
Blerje Materialesh dhe Produktesh	549	522	522	522	522	522
Amortizimi	4,842	3,996	4,224	4,440	4,638	4,827
Furnizim dhe Shërbime - Tarifat E Transmisionit	*4,215*	*4,344*	*4,114*	*4,126*	*4,228*	*4,106*
- Sigurimit						
- Të tjera	*754*	*825*	*825*	*825*	*825*	*825*
Furnizim dhe Shërbime - Të tjera	4,969	5,169	4,939	4,951	5,053	4,931
Aktive te vetëndërtuara	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Rezerva per borxhet e këqija	*5,804*	*6,858*	*5,948*	*5,322*	*4,582*	*3,461*
Shpenzime të tjera	*1,659*	*779*	*779*	*779*	*779*	*779*
Totali i Shpenzimeve Operative	**52,283**	**49,042**	**50,806**	**49,455**	**47,776**	**45,010**
Rezultati Operativ Bruto	**(5,693)**	**1,165**	**2,605**	**6,503**	**12,928**	**15,800**
EBITA	*(851)*	*5,161*	*6,829*	*10,943*	*17,566*	*20,627*
Të Ardhurat Financiare:						
Të Ardhurat nga Interesi	*580*	*279*	*422*	*441*	*420*	*417*

Fitim nga Kursi i Këmbimit	*0*	*205*	*0*	*0*	*0*	*0*
Të ardhura të tjera financiare dhe jo-financiare	*0*	*308*	*0*	*0*	*0*	*0*
Totali i të Ardhurave Financiare	580	792	422	441	420	417
Shpenzimet Financiare:						
Pagesat e Interesit - KESH	*1,838*	*1,410*	*955*	*839*	*719*	*601*
- IFC/EBRD	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
-World Bank	*0*	*0*	*20*	*59*	*94*	*111*
-Overdraft	*1,819*	*1,776*	*2,507*	*2,841*	*3,030*	*2,909*
Pagesat e Interesit	3,657	3,186	3,482	3,739	3,843	3,621
Humbjet nga kursi i këmbimit	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Shpenzime të tjera financiare dhe jo-financiare	*273*	*409*	*318*	*216*	*110*	*0*
Totali i Shpenzimeve Financiare	3,930	3,595	3,800	3,954	3,953	3,621
Shpenzimet Financiare Neto	**(3,350)**	**(2,803)**	**(3,378)**	**(3,513)**	**(3,533)**	**(3,205)**
Fitimi para taksave dhe shpenzimeve të paparashikuara	**(9,043)**	**(1,638)**	**(772)**	**2,990**	**9,395**	**12,595**
Të Ardhura/(Shpenzime) te paparashikuara	*(1,642)*	*4,763*	*0*	*0*	*0*	*0*
Fitimi para Taksave	**(10,685)**	**3,125**	**(772)**	**2,990**	**9,395**	**12,595**
Tatimi mbi Fitimin	*2,324*	*1,378*	*1,895*	*1,988*	*3,101*	*4,028*
Fitimi i Vitit	**(13,009)**	**1,747**	**(2,668)**	**1,002**	**6,293**	**8,567**
Dividenti (10%)	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Fitimi Neto I Shpërndarë	**(13,009)**	**1,747**	**(2,668)**	**1,002**	**6,293**	**8,567**

Aneksi I (b)

Sektori i Energjitik Shqiptar (përjashtuar OST)[i]

Pasqyra e konsoliduar e lëvizjes së Fluksit të Parasë

(Lek/milionë)

	Aktual	Parashikuar				
	2014	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**
A. Aktivitetet Operative:						
Fitim/(humbja) e vitit	(13,009)	1,541	(2,668)	1,002	6,293	8,567
Amortizimi	4,842	3,996	4,224	4,440	4,638	4,826
Amortizimi i granteve	0	0	0	0	0	0
Rezerva per borxhet e këqija	7,080	6,858	5,948	5,322	4,582	3,461
Të tjera jo monetare	0	0	0	0	0	0
Fluksi i Parasë i gjeneruar nga Aktiviteti Operativ	**(1,087)**	**12,395**	**7,505**	**10,764**	**15,513**	**16,854**
Rregullime per:						
(Rritje)/Pakësim i gjendjes së invenarit	569	587	11	0	0	0
Buxhetore, jo buxhetore dhe eksporte	5,000	4,236	(211)	88	(55)	24
Konsumatorët per shitjet me pakicë	**(14,707)**	1409	-6443	(5,744)	(5,084)	(4,089)
OST	*0*	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) i Debitoreve për Energjinë	(9,707)	5,645	(6,653)	(5,656)	(5,140)	(4,064)
Rritje/(Pakësim) i Parapagesave	0	4	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) i Detyrimeve të Shtetit	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) i Debitoreve të Tjerë	(610)	0	0	0	0	0
Rritje/ (Pakësim) e Pagueshme ndaj Furnitorëve	(280)	(226)	1	(1,911)	(134)	(134)
Rritje/(Pakësim) në Detyrimet për Energjinë - WPS	(4,192)	(6,182)	0	0	0	0
Importet -	171	1,381	(105)	(231)	(170)	(167)
Tjetër -	10,794	(2,550)	(2,646)	(2,747)	(2,851)	0
Rritje/(Pakësim) në tarifat e transmetimit të pagueshme	1,455	0	(409)	(823)	(1,263)	(1,637)
Rritje/(Pakësim) i diferencave nga kursi këmbimit	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në taksat e pagueshme	0	(1,040)	191	0	400	621
Rritje/(Pakësim) në detyrimet ndaj personelit	0	17	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në detyrimet afatshkurtra ndaj shtetit	2,825	(9,000)	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në detyrimet e prapambetura	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në rezerva	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në detyrimet afatshkurtra	10,772	(17,600)	(2,969)	(5,711)	(4,018)	(1,317)
Fluksi i Parasë Neto i gjeneruar nga Aktiviteti Operativ	**(62)**	**1,031**	**(2,107)**	**(603)**	**6,355**	**11,473**

B. Aktivitetet e Investimeve:	0	0	0	0	0	0
Rritje/ (Pakësim) në investimet financiare	375	1,530	1,522	1,514	1,514	1,061
Rritje/(Pakësim)në aktivet e paprekëshme	0	0	0	0	0	0
Rritje/(Pakësim) në aktivet e tjera	0	0	0	0	0	0
Blerje e aseteve fikse (-)	(5,779)	(5,612)	(5,339)	(4,950)	(4,628)	(4,268)
Shitjet e aseteve fikse dhe nxjerrja e tyre jashtë perdorimit	0	0	0	0	0	0
	0	0	0	0	0	0
C. Fluksi i parasë i përdorur për investime	**(5,404)**	**(4,082)**	**(3,817)**	**(3,436)**	**(3,114)**	**(3,207)**
Aktiviteti financiar:						
Rritje në kreditë e marra ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare	3,077	0	5,446	4,941	3,778	0
Pagesa Principali	(4,481)	(5,876)	(4,733)	(4,577)	(3,994)	(3,567)
Të Tjera	0	0	0	0	0	0
Pagesa Dividenti	(1,270)	0	0	0	0	0
Kapitali Ulje/Rritje	0	0	0	0	0	0
Fluksi i Parasë nga Aktiviteti Financiar	**(2,674)**	**(5,876)**	**713**	**364**	**(215)**	**(3,567)**
Bilanci i Fluksit të Parasë të Periudhës	**(8,140)**	**(8,928)**	**(5,210)**	**(3,676)**	**3,026**	**4,699**
Gjëndja e Parasë në Fillim të Periudhës	(39,862)	(32,911)	(41,839)	(47,049)	(50,724)	(47,699)
Gjendja e Parasë në Fund të Periudhës	**(32,911)**	**(41,839)**	**(47,049)**	**(50,724)**	**(47,699)**	**(43,000)**
	(48,002)					

Aneksi I (c)

Sektori i Energjitik Shqiptar (përjashtuar OST)

Bilanci i Konsoliduar

(Lek/milionë)

	Aktual	Parashikuar				
	2014	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**
Aktivet						
Aktive të Qëndrueshme						
Ndërtesa, Impiante dhe Pajisje	*142,192*	*146,555*	*152,167*	*157,505*	*162,456*	*167,083*
Investime në Proces	*4,362*	*5,612*	*5,339*	*4,950*	*4,628*	*4,268*
Amortizimi i akumuluar	*42,866*	*46,862*	*51,087*	*55,527*	*60,164*	*64,991*
Llogari te Arkëtueshme Financiare	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Aktive Fikse Neto	**103,689**	**105,305**	**106,419**	**106,929**	**106,919**	**106,360**
Aktive të PaTrupëzuara	*163*	*163*	*163*	*163*	*163*	*163*
Investime Financiare	*11,937*	*10,408*	*8,886*	*7,372*	*5,858*	*4,798*
Aktive të tjera	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Totali i Aktiveve jo-Qarkulluese	**115,789**	**115,875**	**115,467**	**114,464**	**112,940**	**111,321**
Aktive Qarkulluese						
Inventari	*2,820*	*2,232*	*2,221*	*2,221*	*2,221*	*2,221*
Energji - Institucionet buxhetore	*4,237*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
- Eksporti	*0*	*1*	*212*	*123*	*179*	*154*
- Konsumatorët me Pakicë	*69,513*	*68,104*	*74,547*	*80,291*	*85,376*	*89,464*
- OSHEE	*40,668*	*40,668*	*40,668*	*40,668*	*40,668*	*40,668*
- OSHEE	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
- OST	*564*	*564*	*564*	*564*	*564*	*564*
- Tjetër	*5,734*	*5,734*	*5,734*	*5,734*	*5,734*	*5,734*
Debitorët	120,716	115,071	121,725	127,381	132,520	136,585
Rezervat për borxhet e këqija	*(87,395)*	*(94,253)*	*(100,201)*	*(105,523)*	*(110,105)*	*(113,566)*
Parapagesa	*(4)*	*(8)*	*(8)*	*(8)*	*(8)*	*(8)*
Shteti	*2,286*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Arka dhe Banka	*324*	*1,387*	*0*	*0*	*0*	*2,821*
Diferenca nga Kursi Këmbimit	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Totali i Aktiveve Qarkulluese	*38,747*	**24,430**	**23,737**	**24,071**	**24,628**	**28,052**
	0	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Totali i Aktiveve	**154,536**	**140,305**	**139,204**	**138,534**	**137,569**	**139,373**
DETYRIMET DHE KAPITALI I VET						
Kapitali i Vet						
Kapital i Nënshkruar	*50,139*	*50,139*	*50,139*	*50,139*	*50,139*	*50,139*
Kapitali i Rregjistruar i Papaguar	*(4)*	*(4)*	*(4)*	*(4)*	*(4)*	*(4)*
Rezerva e Rivlerësimit	*46,493*	*46,493*	*46,493*	*46,493*	*46,493*	*46,493*
Rezervat	*7,533*	*7,533*	*7,533*	*7,533*	*7,533*	*7,533*

Fitime të mbartura/(Humbje të mbartura)	*(90,470)*	*(103,479)*	*(101,937)*	*(104,605)*	*(103,603)*	*(97,310)*
Fitimi/(Humbja) e Vitit	*(13,009)*	*1,541*	*(2,668)*	*1,002*	*6,293*	*8,567*
Totali i Kapitalit të Vet	**683**	**2,224**	**(444)**	**558**	**6,852**	**15,418**
Detyrime afatgjata						
Kreditë	*35,534*	*30,873*	*31,815*	*33,125*	*33,336*	*30,526*
Grante Qeveritare	*143*	*143*	*143*	*143*	*143*	*143*
Të Tjera	*1,424*	*1,424*	*1,424*	*1,424*	*1,424*	*1,424*
Totali i detyrimeve afatgjata	**37,100**	**32,440**	**33,381**	**34,692**	**34,903**	**32,093**
Detyrime afatshkurtra						
Kreditë	*6,750*	*5,534*	*5,306*	*4,360*	*3,933*	*3,176*
Overdraft	*35,520*	*43,226*	*47,049*	*50,725*	*47,699*	*45,821*
Furnitore (Materiale dhe shërbime)	*2,617*	*2,391*	*2,392*	*481*	*347*	*212*
Blerjet e Energjisë - WPS	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
- IPPs	*6,182*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
- Vlorë	*0*	*1,381*	*1,276*	*1,045*	*875*	*708*
- Importeve	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
- Të Tjera	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*	*0*
Blerjet e Energjisë	**6,182**	**1,381**	**1,276**	**1,045**	**875**	**708**
OSHEE Sh.a	*10,794*	*8,244*	*5,598*	*2,851*	*0*	*0*
Tarifat e Transmetimit	*9,065*	*9,065*	*8,656*	*7,833*	*6,569*	*4,933*
Taksat e Pagueshme	*10,324*	*9,284*	*9,475*	*9,475*	*9,875*	*10,496*
Personeli	*34*	*51*	*51*	*51*	*51*	*51*
Shteti	*17,525*	*8,525*	*8,525*	*8,525*	*8,525*	*8,525*
Shpenzimet e Përllogaritura	*9,275*	*9,275*	*9,275*	*9,275*	*9,275*	*9,275*
Rezervat	*8,667*	*8,667*	*8,667*	*8,667*	*8,667*	*8,667*
Totali i llogarive të pagueshme	74,482	56,882	53,913	48,202	44,183	42,866
Totali i Detyrimeve Afatshkurtra	**116,752**	**105,642**	**106,268**	**103,286**	**95,816**	**91,864**
Totali i Detyrimeve	**153,853**	**138,083**	**139,649**	**137,978**	**130,719**	**123,957**
Totali i Detyrimeve dhe i Kapitalit të Vet	**154,536**	**140,307**	**139,206**	**138,536**	**137,570**	**139,375**
Raporte Financiare						
Marzhi i Fitimit (%)	*-27.9%*	*3.1%*	*-5.0%*	*1.8%*	*10.4%*	*14.1%*
Raporti i mbulimit të Borxhit		*0.1*	*0.1*	*0.2*	*0.3*	*0.4*
Borxhi /Raporti Total i Kapitalizimit(%)	*24.0%*	*23.1%*	*24.0%*	*25.0%*	*25.4%*	*23.0%*

[i] Këto shifra do të jenë subjekt i ndryshimeve në varësi të rezultatave të auditimit vjetor.

VENDIM
Nr. 172, datë 25.2.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV KORÇË - ZËMBLAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Korçë-Zëmblak, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të "Operatorit të Sistemit të Transmetimit", sh.a., (OST).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 3 204 (tre mijë e dyqind e katër) m², tokë bujqësore "arë" dhe "truall", vlerësuar me shumën 535 724 (pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekë.

4. Fondi prej 535 724 (pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e katër) lekësh të përballohet nga fondet e OST, sh.a.-së.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të përballohet nga OST, sh.a.-ja, si subjekti që garanton edhe shpenzimet për realizimin e këtij procesi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit shkurt 2015.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojnë të gjitha transaksionet mbi këto pasuri, deri në përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë të pasurive të shpronësuara në favor të OST, sh.a-së.

8. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OST, sh.a.-ja, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE LINJES 110 KV " KORCE-ZEMBLAK "

Qarku: Korce, Rrethi Korce
Bashkia: Korce,
Komuna: Pojan, Komuna Qender,
Lloji I pasurise se palujteshme qe shpronesohet: Toke bujqesore Are, Truall,

Numri i shtylles	Emri, Atesia, Mbiemri			Te dhena per pronesine					Vlera ne leke/m2 sipas ll.te pasurise	Vlera Sip shpronesim lek	Shenime
				Lloji I pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Sasia e sip prones m2	Sip shtylles shpronesim m2			
1	2			3	4	5	6	7	8	9	10
QARKU KORCE											
Komuna Pojan											
Fshati Zëmblak											
1	Pretendues			are	3903	112/28		152	212	32224	nuk ka informacion
1	Pretendues			are	3903	112/29					
2	Pretendues			are	3903	109/21		62	212	13144	nuk ka informacion
3	Kujtim	Veli	Bregu	are	3903	117/7	660	62	212	13144	
4	Rahmi	Mahmut	Myftarlli	are	3903	117/75	1073	62	212	13144	
4	Muhamet	Rakip	Myftarlli	are	3903	117/78	1206				
5	Sali	Abaz	Sotomeni	are	3903	120/13	2025	62	212	13144	
5	Pellumb	Ibrahim	Kulla	are	3903	120/16	1296				
6	Virjon		Lilollari	are	3903	129/43	568	71	212	15052	
6	Guradem	Selfo	Bregu	are	3903	129/44	1211				
7	Pellumb	Ilmi	Shpata	are	3903	129/72	5930	62	212	13144	
7	Agim	Ilmi	Shpata	are	3903	129/73	6972		212	212	
8	Seit	Islam	Dido	are	3903	76/1/17	890	152	212	32224	
9	Nuri		Muca	are	3903	75/1/10	6750	62	212	13144	
9	Medat	Dilaver	Burnazi	are	3903	75/1/11	7787				
Fshati Plasë											
10	Shaban	Kasem	Arapi	are	2984	73/47	2430	62	212	13144	
11	Tafil	Ismail	Korkuti	are	2984	73/17	2940	75	212	15900	
12	Jani	Avdyl	Mele	are	2984	70/68	1592	62	212	13144	
12	Urim	Avdyl	Fezolli	are	2984	70/69	1500				
13	Sali	Mustafa	Agolli	are	2984	65/17	960	62	212	13144	
13	Ramadan	Gurali	Uci	are	2984	65/18	1050				
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				1008			
				Vlera totale ne leke per Komunen Pojan						213908	

Numri i shtylles	Emri, Atesia, Mbiemri			Te dhena per pronesine					Vlera ne leke/m2 sipas ll.te pasurise	Vlera Sip shpronesim lek	Shenime
				Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Sasia e sip prones m2	Sip shtylles shpronesim m2			
Komuna Qendër (Bulgarec)											
Fshati Kuc i Zi											
14	Hysni	Qani	Prroji	are	2307	14/53	522	75	212	15900	
15	Agron	Idriz	Beqiri	are	2307	13/12	5689	62	212	13144	
15	Arben	Haki	Beqiri	are	2307	13/11	3203				
16	Arben, Meznet		Nasufi	are	2307	31/7	2926	62	212	13144	Bashkepronesi
17	Nesim	Qerim	Osmanlli	are	2307	39/7	5038	62	212	13144	
18	Ajet	Selaudin	Beqirllari	are	2307	57/7	5169	62	212	13144	
19	Pretendues			are	2307	56/9	1010	152	212	32224	nuk ka informacion
Fshati Belorta											
20	Viktor	Ali	Kodra	are	1145	607/44	955	62	212	13144	
20	Rakip	Baki	Alimi	are	1145	607/45	4011				
21	Baftjar	Adil	Shaholli	are	1145	72/15	4207	62	212	13144	
Fshati Nevicisht											
22	Mentor		Xhaholli	are	2783	114/14	1000	75	212	15900	
22	Perparim	Hajrulla	Mance	are	2783	114/15	2000				
Fshati Dishnicë											
23	Andon	Dhori	Kocaqi	are	1491	16/13	4757	62	212	13144	
23	Nuni	Ndreci	Nunka	are	1491	16/14	5410				
24	Aferdita		Aliko	are	1491	16/17	382	62	212	13144	
24	Mevlude		Kroi	are	1491	16/18	3438				Bashkepronesi
25	Bardhyl	Gani	Mullalli	are	1491	37/1	4717	62	212	13144	
26	Islam	Rushan	Mullalli	are	1491	37/14	1660	62	212	13144	
27	Bujar	Qerim	Bregu	are	1491	65/1	3500	152	212	32224	
28	Tela	Banush	Banushi	are	1491	65/20	7300	75	212	15900	
29	Xhevdet	Qani	Shkembi	are	1491	61/3	14160	71	212	15052	
Fshati Barc											
30	Astrit	Hilmi	Ravolli	are	1101	203/9	4676	71	212	15052	
30	Medi	Sulejman	Dedelli	are	1101	203/10	5645				Bashkepronesi
31	Xhevahir	Qani	Ravolli	are	1101	695/1	16789	152	212	32224	
32	Nazmi	Sefedin	Callo	are	1101	213/13	4597	75	212	15900	
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				**1518**			
				Vlera totale ne leke per Komunen Qender						**321816**	

Numri i shtylles	Emri, Atesia, Mbiemri			Te dhena per pronesine					Vlera ne leke/m2 sipas ll.te pasurise	Vlera Sip shpronesimlek	Shenime
				Lloji i pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Sasia e sip prones m2	Sip shtylles shpronesim m2			
Bashkia Korce											
N.B.Korcë											
33	Pretendues				8561	30/2		75			nuk ka informacion
34	Pretendues				8561			75			nuk ka informacion
35	Pretendues				8561	10/103		152			nuk ka informacion
36	Pretendues				8561			81			nuk ka informacion
37	Pretendues				8561			81			nuk ka informacion
38	Pretendues				8561			62			nuk ka informacion
39	Pretendues				8561			152			nuk ka informacion
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				678			
				Vlera totale ne leke per Bashkine Korce							
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				3,204.00			
				Vlera totale ne leke per linjen Zemblak - Korce						535724	

VENDIM
Nr. 173, datë 25.2.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV ERSEKË-KORÇË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Ersekë-Korçë, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., (OST).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 969.17 (një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë shtatëmbëdhjetë) m², tokë bujqësore "arë' dhe 'truall", vlerësuar në shumën 276 006.24 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtë pikë njëzet e katër) lekë.

4. Fondi prej 276 006.24 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtë pikë njëzet e katër) lekësh të përballohet nga fondet e OST, sh.a.-së.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit të përballohet nga OST, sh.a, si subjekti që garanton shpenzimet për realizimin këtij procesi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit shkurt 2015.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Ersekë dhe Korçë të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri, deri në përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuara në favor të OST, sh.a.-së.

8. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OST, sh.a.-ja, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Ersekë dhe Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE LINJES 110 KV "Korce-Erseke"

Qarku: Korce, Rrethi Kolonje
Bashkia: Korce, Erseke,
Komuna: Drenove, Mollaj, Mollas, Komuna Qender Erseke,
Lloji I pasurise se palujteshme qe shpronesohet: Toke bujqesore Are, Truall,

Numri I shtylles	Emri , atesia, mbiemri			Te dhena per pronesine								Shenime
				Lloji I pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Sasia e prones m2	sip shtylles, shpronesim m2				
Qarku: Korce, Rrethi Korce												
Bashkia Korce												
1	Flora		Lavdari		8561	9/96	1650	23.2				
2	Pretendues				8561			18.1				nuk ka informacion
3	Pretendues				8561			15.15				nuk ka informacion
4	Pretendues				8561			23.2				nuk ka informacion
5	Pretendues				8561			16.6				nuk ka informacion
6	Estref		Fidani		8561	9/45	250	28.1				
7	Familja		Mano		8561	9/65	500	28.1				Bashkepronesi
8	Pretendues				8561	8/178		19.7				nuk ka informacion
9	Pretendues				8561	88		19.2				nuk ka informacion
10	Pretendues				8561	102		16.6				nuk ka informacion
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				207.95				
				Vlera totale ne leke								
Komuna Drenove												
Fshati Turan												
11	Meleq		Beshiri	are	3660	103/23	3320	18.1	212		3837.2	
12	Afroviti		Kosta	are	3660	132/15	3000	23.2	212		4918.4	

Numri I shtylles	Emri , atesia, mbiemri			Te dhena per pronesine							Shenime
				Lloji I pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Sasia e prones m2	sip shtylles, shpronesim m2			
13	Donika, Feim		Pasho	are	3660	137/3	2750	16.6	212	3519.2	
14	Muharem		Micani	are	3660	137/17	9000	16.6	212	3519.2	
Fshati Drenove											
15	Ilia	Bari	Miska	are	1538	100/104/121	3000	18.1	212	3837.2	
16	Petraq	Kristo	Kapurani	are	1538	103/8	1500	19.7	212	4176.4	
Fshati Qatrom											
17	Pretendues			are	3088			16.6	212	3519.2	nuk ka informacion
18	Pretendues			are	3088			18.1	212	3837.2	nuk ka informacion
19	Pretendues			are	3088			19.7	212	4176.4	nuk ka informacion
20	Pretendues			are	3088	171		16.6	212	3519.2	nuk ka informacion
21	Pretendues			are	3088	171		18.1	212	3837.2	nuk ka informacion
22	Pretendues			are	3088	91		23.2	212	4918.4	nuk ka informacion
23	Pretendues			are	3088	91		47.8	212	10133.6	nuk ka informacion
24	Dashamir	Xhemal	Ustalli	are	3088	78/3		19.7	212	4176.4	
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				292.1			
				Vlera totale ne leke						61925.2	
Komuna Mollaj											
Fshati Mollaj											
25	Bashkim		Muke	are	2716	4000		15.2	212	3222.4	
26	Esat		Lushi	are	2716	2200		19.7	212	4176.4	
27	Robert		Bacelli	are	2716	2650		21.3	212	4515.6	
28	Kasem		Shametaj	are	2716	3000		28.02	212	5940.24	
29	Sazan		Shkembi	are	2716	2500		18.1	212	3837.2	
30	Rami		Shkembi	are	2716	5000		23.2	212	4918.4	
31	Refik		Burimi	are	2716	4000		15.2	212	3222.4	
32	Hysni		Mustafa	are	2716	3500		15.2	212	3222.4	
33	Xhevit		Feimi	are	2716	2500		15.2	212	3222.4	

Numri I shtylles	Emri , atesia, mbiemri			Te dhena per pronesine							Shenime
				Lloji I pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Sasia e prones m2	sip shtylles, shpronesim m2			
34	Nevruz		Shkembi	are	2716	3000		16.6	212	3519.2	
35	Tajar		Selimi	are	2716	1800		16.6	212	3519.2	
36	Pretendues			are	2716	1000		15.2	212	3222.4	nuk ka informacion
Fshati Kamenice											
37	Hava	Abdulla	Jahja	are	2063	21/36,21/21	8500	15.2	212	3222.4	
37	Pranvera	Bajram	Hysolli	are	2063	21/37	490				
38	Xhevdet	Riza	Sali	are	2063	21/8	6910	15.2	212	3222.4	
39	Pretendues			are	2063	35/8		15.2	212	3222.4	nuk ka informacion
40	Arqilea	Ali	Qerim	are	2063	36/11	7000	16.6	212	3519.2	
41	Familja		Veizi	are	2063	43/10		18.1	212	3837.2	
42	Familja		Ismaili	are	2063	67/17		15.2	212	3222.4	Bashkepronesi
43	Gani	Rifat	Hyska	are	2063	105/1	4380	15.2	212	3222.4	
44	Kamber	Qamil	Aska	are	2063	163/14	10630	15.2	212	3222.4	
45	Esat	Shaban	Bezolli	are	2063	164/14	5000	15.2	212	3222.4	
Fshati Floq											
47	Bilbil	Resul	Elezi	are	1631	21/30	9020	15.2	115	1748	
48	Shyqyri		Mullaj	are	1631	21/9	2480	23.2	115	2668	
49	Myrteza	Shefqet	Dikolli	are	1631	30/2	1528	15.2	115	1748	
50	Thoma	Janaq	Mejdi	are	1631	62/20	3000	15.2	115	1748	
51	Teki		Hasankolli	are	1631	67/11	3200	18.1	115	2081.5	
52	Sali	Besim	Bekolli	are	1631	84/3	3400	15.2	115	1748	
53	Xhemal	Hasan	Ramolli	are	1631	81/3	1700	15.2	115	1748	
54	Pretendues			are	1631	82/14		15.2	115	1748	nuk ka informacion
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				493.12			
				Vlera totale ne leke						91688.94	
Qarku: Korce, Rrethi Kolonje											
Komuna Mollas											

Numri I shtylles	Emri , atesia, mbiemri			Te dhena per pronesine							Shenime
				Lloji I pasurise	Nr. Kadastrai	Nr. pasurise	Sasia e prones m2	sip shtylles, shpronesim m2			
Fshati Pepellash											
67	Rakip	Bektash	Rakipi	are	2906	24/1	9699	15.2	135	2052	
72	Pretendues			are	2906	79	4848	21.3	135	2875.5	nuk ka informacion
74	Pretendues			are	2906			76	135	10260	nuk ka informacion
75	Pretendues			are	2906			34.5	135	4657.5	nuk ka informacion
76	Pretendues			are	2906			15.2	135	2052	nuk ka informacion
Fshati Helmes										0	
77	Pretendues				1948	133		15.2	135	2052	nuk ka informacion
78	Pretendues				1948	292/2		16.6	135	2241	nuk ka informacion
79	Pretendues			are	1948	296/2	7722	23.2	135	3132	nuk ka informacion
81	Pretendues			are	1948	771/2/30	3450	21.3	135	2875.5	
82	Veip	Haki	Nazarko	pemetore	1948	303/3	1776	15.2	135	2052	
83	Pretendues				1948			16.3	135	2200.5	nuk ka informacion
84	Pretendues				1948			15.2	135	2052	nuk ka informacion
Fshati Mollas											
85	Malush	Iljaz	Malushi	are	2719	1/38	1848	15.2	135	2052	
86	Barjam	Ibraim	Aliko	are	2719	1/78	3605	15.2	135	2052	
87	Pretendues			are	2719			15.2	135	2052	nuk ka informacion
88	Pretendues			are	2719			23.2	135	3132	nuk ka informacion
89	Murat	Nevruz	Fataj	are	2719	4/4	2520	15.2	135	2052	
90	Gentian	Ibraim	Xake	are	2719	30/94	3900	15.2	135	2052	
91	Seit	Feti	Munellari	are	2719	30/319	4230	15.2	135	2052	
92	Resmi	Islam	Elmazllari	are	2719	35/61	3780	15.2	135	2052	
93	Estref	Refat	Jaupi	are	2719	35/43	3798	15.2	135	2052	
94	Dhionis	Kole	Kapurani	are	2719	59/10	4810	15.2	135	2052	
Fshati Qinam											
95	Pretendues			are	3117			16.6	135	2241	nuk ka informacion

Numri I shtylles	Emri , atesia, mbiemri			Te dhena per pronesine							Shenime
				Lloji I pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Sasia e prones m2	sip shtylles, shpronesim m2			
96	Pretendues			are	3117			15.2	135	2052	nuk ka informacion
97	Pretendues			are	3117			15.2	135	2052	nuk ka informacion
98	Pretendues			are	3117			15.2	135	2052	nuk ka informacion
99	Pretendues			are	3117			16.6	135	2241	nuk ka informacion
100	Pretendues			are	3117			15.2	135	2052	nuk ka informacion
101	Pretendues			are	3117			15.2	135	2052	nuk ka informacion
102	Pretendues			are	3117			19.7	135	2659.5	nuk ka informacion
103	Pretendues			are	3117			18.1	135	2443.5	nuk ka informacion
104	Pretendues			are	3117			47.8	135	6453	nuk ka informacion
105	Pretendues			are	3117			15.2	135	2052	nuk ka informacion
106	Pretendues			are	3117			19.7	135	2659.5	nuk ka informacion
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				674.9			
				Vlera totale ne leke						91111.5	
Komuna Qender Erseke											
Fshati Selenice											
107	Pretendues			kullote	3284	357/1	6630	15.2	105	1596	nuk ka informacion
108	Pretendues			are	3284	371/30	73923	16.6	142	2357.2	nuk ka informacion
109	Xhezo	Xhelal	Asllani	are	3284	457/23	14027	16.6	142	2357.2	
110	Agron	Mersin	Diko	are	3284	457/30	6975	15.2	142	2158.4	
111	Pretendues			are	3284	457/10	23347	15.2	142	2158.4	nuk ka informacion
113	Ismail	Kamber	Mujo	pemetore	3284	508/91	638	15.2	142	2158.4	
Fshati Bejkove											
115	Ramadan	Rakip	Sheko	are	1136	27/5	7104	15.2	135	2052	
116	Eqerem	Xhevo	Shalasi	are	1136	27/10	11000	15.2	135	2052	
118	Safet	Abaz	Bregu	are	1136	48/17	18248	18.1	135	2443.5	
119	Petrit	Naki	Sheko	are	1136	134/7	3360	15.2	135	2052	
Fshati Psar				are							

Numri I shtylles	Emri , atesia, mbiemri			Te dhena per pronesine							Shenime
				Lloji I pasurise	Nr. Kadastral	Nr. pasurise	Sasia e prones m2	sip shtylles, shpronesim m2			
120	Perparim	Sali	Dervishi	are	3066	98/13	7205	15.2	135	2052	
121	Rexhep	Irfan	Caco	are	3066	98/2	3369	23.2	135	3132	
122	Luan	Ethem	Jupe	are	3066	92/4	3951	15.2	135	2052	
123	Durim	Muharem	Gramo	are	3066	453/1	3656	19.7	135	2659.5	
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				231			
				Vlera totale ne leke						31280.6	
Bashkia Erseke											
125	Pretendues				1594	6	67159	15.2			nuk ka informacion
126	Mina		Dhimo		1594	25/7	3616	15.2			
127	Fatime		Caka		1594	25/19	1652	23.2			
128	Sotir		Prifti		1594	25/40	4400	16.5			
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				70.1			
				Vlera totale ne leke							
				Siperfaqja totale shpronesimi m2				**1,969.17**			
				Vlera totale ne leke						**276006.24**	

VENDIM
Nr. 175, datë 25.2.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "PORTO ROMANO-DURRËS, LOTI I"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Porto Romano-Durrës, loti I".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 4 478 606 (katër milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekësh, nga të cilat:

a) për pasurinë "truall", me sipërfaqe 868 (tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) m^2 me vlerën 2 867 004 (dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katër) lekë;

b) për objekte, me vlerë shpronësimi 1 611 602 (një milion e gjashtëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 478 606 (katër milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtë) lekë të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri "Shpronësime", planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar ZVRPP", të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

Lista emërore e pronarëve që shpronësohen nga ndërtimi i segmentit rrugor "Porto Romano Durrës" Loti I

Nr.	Emri	Mbiemri	Z. K	Nr. Pas	Sip. Përgj. m²	Lloji i Pasurisë					Shuma (Lekë)	Shënime
						TRUALL			OBJEKTE			
						m²	Çmimi	Vlera lekë	Lloji	Vlera lekë		
1	Vladimir	Bruci	8517	152/233	247.2	26	3303	85878			85878	Konfirmuar ZVRPP
2	Shpëtim	Aliaj	8517	152/21	301.16	158	3303	521874			521874	Konfirmuar ZVRPP
3	Adriatik	Shahini	8517	152/238	300	300	3303	990900	Banese 1 kt 18 m2	203822	1194722	Konfirmuar ZVRPP
4	Tire	Kutrici	8517	152/61	184	184	3303	607752	Banese 1 kt 24 m2	435726	1043478	Konfirmuar ZVRPP
5	Bege	Allaraji	8517	152/312	300	200	3303	660600	Objekt 1 kt	972054	1632654	Konfirmuar ZVRPP
	SHUMA					868		2867004		1611602	4478606	

VENDIM
Nr. 176, datë 25.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 28, DATË 14.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA E SHËRBIME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas nënpikës 1.2., të vendimit nr. 28, datë 14.1.2015, të Këshillit të Ministrave, shtohet nënpika 1.3., me këtë përmbajtje:

"1.3. Përjashtimisht, lejohen përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH-së, të akredituara jashtë vendit, që procedurat për blerje automjetesh t'i realizojnë vetë, sipas rregullave të tyre të brendshme.".

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe përfaqësitë diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë, të akredituara jashtë vendit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 177, datë 25.2.2015

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN "RSM", NË SHTABIN E TRAJNIM-KËSHILLIMIT DHE NDIHMËS, NË KUADËR TË INICIATIVËS SË KARTËS SË ADRIATIKUT, NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin "RSM", të përbërë nga 2 (dy) ushtarakë, në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës, në Mazar-e-Sharif, në

Afganistan, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut.

2. Misioni i personelit që do të marrë pjesë është mbështetja dhe dhënia e kontributit në funksione të ndryshme në Shtabin e Trajnimi-Këshillimit dhe Ndihmës, në operacionin e NATO-s "RSM", në Afganistan, në kuadër të iniciativës së Kartës së Adriatikut.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data 1 mars 2015. Periudha e qëndrimit në mision për çdo përfaqësues do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrjen dhe dorëzimin e detyrës dhe vonesa të transportit strategjik për ndërrimin me kontingjentin e radhës.

4. Venddislokimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës, në Mazar-e-Sharif, në Afganistan.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

ë) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit që do të dërgohet me mision në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy-ose shumëpalëshe ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 178, datë 25.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 145, DATË 20.2.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË SHTABIN "EUFOR", NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK "ALTHEA", TË BASHKIMIT EVROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 145, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

"3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 5 (pesë) vjet, afat, i cili fillon të llogaritet nga data 26 shkurt 2015. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë, së cilës i

shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 182, datë 25.2.2015

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS PËR PËRZGJEDHJEN E RREGULLUESIT KRYESOR (*LEAD MANAGER*) DHE/OSE HUADHËNËSIT PËR REALIZIMIN E HUAMARRJES ME INSTRUMENTE FINANCIARE NË TREGUN E HUAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, shkronja “ç”, dhe paragrafi i dytë, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e procedurës që do të ndiqet për procesin e përzgjedhjes së rregulluesit kryesor (*Lead Manager)* dhe/ose huadhënësit dhe përmbushjen e kësaj procedure për realizimin e huamarrjes me instrumente financiare në tregun e huaj.

2. Bazuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe strategjinë e menaxhimit të borxhit publik, me propozim të strukturës përgjegjëse për huamarrjen, ministri i Financave miraton kërkesën për propozim për përzgjedhjen e rregulluesit kryesor (*Lead Manager*) dhe/ose huadhënësit dhe publikimin e saj.

3. Në kërkesën për propozim duhet të përcaktohen:

a) qëllimi i financimit;

b) shuma që synohet të merret hua;

c) kriteret e përzgjedhjes në përputhje me nenin 6, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”;

ç) afati i paraqitjes së propozimeve;

d) data, ora dhe vendi i paraqitjes së propozimeve;

dh) çdo element tjetër i vlerësuar si i nevojshëm.

4. Në rast se përpara përfundimit të afatit të dorëzimit të propozimeve institucionet e interesuara kërkojnë shtyrjen e këtij afati, titullari i institucionit pas shqyrtimit të kërkesës vendos pranimin ose refuzimin e saj. Vendimi për shtyrjen e afatit publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

5. Ministria e Financave publikon ftesën për ofertë në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave dhe në dy numra të njëpasnjëshëm në gazetën “*Financial Times*”.

6. Pas dorëzimit zyrtar në protokollin e Ministrisë së Financave të propozimeve nga institucionet e interesuara, struktura përgjegjëse për huamarrjen në Ministrinë e Financave fillon vlerësimin e tyre. Afati për kryerjen e vlerësimeve është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e përfundimit të afatit për dorëzimin e propozimeve. Në varësi të analizave paraprake të propozimeve, në rast se struktura e huamarrjes e gjykon të arsyeshme, mund t’u kërkojë institucioneve financiare propozuese të dërgojnë sqarime dhe informacion shtesë duke iu caktuar dhe afatin e paraqitjes së tyre. Në këtë rast afati i vlerësimit shtyhet me 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së sqarimeve shtesë.

7. Vlerësimi i propozimeve kryhet nga struktura përgjegjëse për huamarrjen në ministri, duke u bazuar në:

a) eksperiencën e institucionit në transaksione të ngjashme, prezencën e tyre në tregje dhe kapacitetin për sigurimin e financimit të kërkuar;

b) risqet e ndryshme që mbart secili prej propozimeve;

c) koston më të ulët efektive me të gjitha elementet e saj si:

i) afati i maturimit;

ii) mënyrat e shlyerjes;

iii) komisionet, interesi dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në koston e huamarrjes në varësi të kushteve të tregut.

8. Struktura përgjegjëse për huamarrjen në ministri përgatit një raport përmbledhës, ku renditen institucionet pjesëmarrëse në procedurë, të cilin ia dërgon për miratim ministrit.

9. Ministri, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike

nga paraqitja e propozimit të bërë nga struktura përgjegjëse e huamarrjes, vendos të miratojë ose të refuzojë shpalljen e fituesit për rregulluesin kryesor (*Lead Manager*) dhe/ose huadhënësit apo të përsëritë procedurën.

10. Shpallja e fituesit publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

11. Ankesat e subjekteve ndaj procedurës së zhvilluar i paraqiten, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e njoftimit, ministrit i cili merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së ankesës.

12. Ministri, pas përfundimit të afatit të ankimit, negocion dhe nënshkruan letrën e mandatimit me institucionin fitues, e cila përmban, ndërmjet të tjerash, termat kryesorë të ofrimit të shërbimit.

13. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 350 lekë